




# Koha

www.koha.mk



**Poetja Izabela,  
pasardhësja e  
Skënderbeut**

Fq.12-13

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3271 · e premte/e diel 19-21 janar, 2018

-2°C |+6°C

15 DEN

## EDITORIAL

### Ivanoviqi dhe Republika Srpska



Atentati ndaj njërit prej liderëve të serbeve lokalë në Mitrovicën e veriut, Oliver Ivanović, mund të jetë një ngjarje me rrezatim pak më të gjerë dhe të gjithë ata që mendojnë se kjo vrasje ka të bëjë vetëm me Kosovën dhe Serbinë, gabohen. Serbët historikisht janë dëshmuar mjeshtër të krijimit të situatave spektakolare që kanë ndikuar shumë në rrjedhën e ngjarjeve e rrethanave me epilog shumë dramatik. Kujtojmë atentatin në Sarajevë ndaj trashëguesit të fronit austro-hungarez, Franc Ferdinandit (28 qershor të vitit 1911)...

Fq.2

## RAJON

### Media kroate zbulon vrasësin e Ivanoviqit

Fq.14

## GLOBI

### Trupat amerikane mbeten në Siri

Fq.15



## STOLTENBERG TAKIM ME AUTORITETET MË TË LARTA SHTETËRORE

# EMRI, PASTAJ NË NATO



Sekretari përgjithshëm i NATO-së, Jens Stoltenberg, pas takimit që pati me kryeministrin Zoran Zaev dhe zyrtarët tjerë shtetëror, përsëriti se organizata që drejton ai, nuk ka një plan B për anëtarësim në NATO nëse vonohet zgjidhja e çështjes së emrit me Greqinë. "Duke e parë flamurin e Malit të Zi si valoi për herë të parë para selisë së NATO-s vitin e kaluar, këtë e ndjej si moment shumë të rëndësishëm. Ende ka vend për shumë flamuj para selisë së NATO-s. Vendet-anëtare janë inspiruar nga përkushtimi dhe entuziazmi juaj për hyrje në Aleancë, ndërsa NATO-ja dëshiron që të keni sukses", tha Stoltenberg

Fq.3

## Komunat, 120 milionë euro borxhe

Shkup, 18 janar - Borxhet e komunave për energji elektrike, punë të kryera ndërtimore apo shërbime të tjera, vlerësohen të jenë afër 120 milionë euro. Vetëm deri në fund të vitit 2016 borxhet kanë arritur në 82 milionë euro. Por borxhi i komunave mund të jetë edhe më i madh, duke tejkaluar shifrën prej 120 milionë euro, nëse shtohen edhe obligimet në bazë të vendimeve gjyqësore dhe të kamatave. Sipas

analizës së revizorëve, ekziston mosharmonizim i madh midis evidencës së komunave dhe numrave të Ministrisë së Financave lidhur me borxhet që i kanë komunat në bazë të vendimeve ekzekutive gjyqësore. Nga të dhënat e diktasterit të financës, merret vesh se obligimet në bazë të vendimeve gjyqësore, arrijnë 37.4 milionë euro, ndërsa evidenca e komunave tregon se obligimet janë afër...

Fq.7



## EDITORIAL

# IVANOVIQI DHE REPUBLIKA SRPSKA



Emin AZEMI

Atentati ndaj njërit prej liderëve të serbeve lokalë në Mitrovicën e veriut, Oliver Ivanoviq, mund të jetë një ngjarje me rrezatim pak më të gjerë dhe të gjithë ata që mendojnë se kjo vrasje ka të bëjë vetëm me Kosovën dhe Serbinë, gabohen. Serbët historikisht janë dëshmuar mjeshtër të krijimit të situatave spektakolare që kanë ndikuar shumë në rrjedhën e ngjarjeve e rrethanave me epilog shumë dramatik.

Kujtojmë atentatin në Sarajevë ndaj trashëguesit të fronit austro-hungarez, Franc Ferdinandit (28 qershor të vitit 191), që ishte prelude i Luftës së Parë Botërore, që pasoi me sulmin e Austro-hungarisë ndaj Serbisë. Edhe sot madje atentati i Sarajevës perceptohet me dioptri të ndryshme nga nxënësit e Bosnjës. Për boshnjakët dhe kroatët Gavrilo Principi ishte një atentator politik i Beogradit. Për serbët e Bosnjës, ky atentat ishte vetëm pretekst për Austro-Hungarinë dhe Gjermaninë të kryejnë agresion ushtarak ndaj Serbisë.

Tani, çfarë lidhjeje mund të ketë vrasja e Oliver Ivanoviqit me situatën në Bosnjë e Hercegovinë? Nëse jo drejtpërdrejt, kjo vrasje krijon shumë paradigma të tërthorta që ndërldhin ngjarjet e alibitë, por hedh dritë edhe mbi mundësinë e përdorjes së Kosovës nga ana e Beogradit si pretekst për një rieditim të ri ballkanik. Nëse Ivanoviqi ishte sinonimi i një mendësie rebele serbe që ishte kundër ndarjes së Kosovës, kjo i ka mjaftuar Beogradit për ta asgjësuar këtë sinonim, sepse ndryshe nuk do të kishte kurrfarë atuje të arsyetonte deklaratimet sparatiste të politikanëve në Banja Llukë për shpërbërjen e Republika Sërpskës nga BeH dhe bashkëngjiten me Serbinë.

Stabilizimi i Kosovës, që nënkupton edhe integrimin e serbëve në shoqërinë kosovare, nga koniukturat e Beogradit është shikuar me sy jo të mirë. Të gjithë ata që autorësinë e kësaj vrasjeje e kërkojnë jashtë Kosovës, në fakt bëjnë një lexim nën rreshta të mesazhit që përcjell ky atentat. Të temposh këtë vrasje vetëm pak ditë para fillimit me punë të Gjykatës Speciale, kur Prishtina e hutuar po merret me shumë me vetveten se sa më problemet reale që po e rrezikojnë të ardhmen e Kosovës, është një linjë e mprehtë veprimi të cilën Beogradi e ka aktivizuar gjithmonë kur ka dashur të poentojë dy e më shumë efekte.

Në radhë të parë, Beogradi e ka shumë të qartë se Prishtina nuk do të mundet ta zbulojë vrasësin e vërtetë të Ivanoviqit dhe kjo do të mjaftojë ta shpallë Kosovën të paaftë për të administruar situata kaotike të cilat i krijojnë vetë Serbia. Kjo e fundit, pa e ftuar askush, pastaj ofrohet si shpëtimtare dhe te aparatçikët e Brukselit kjo mund të krijojë përshtypje të mire, sepse ata ngazëlleshën me formën dhe jo me përmbajtjen e dramës ballkanike.

Involvimi i Serbisë në gjoja stabilizimin e situatës në veri të Kosovës, do t'ia hape udhën asaj t'i fusë hundët edhe në Bosnjë e Hercegovinë, atje ku edhe e ka synimin kryesor. Karta e quajtur Oliver Ivanoviq do të përdoret nga Beogradi edhe si biletë për të hyrë sa herë të dojë në Kosovë, por edhe si "shengen" për të integruar tokat serbe nën një ombrellë.

Mjafton të eliminohen ata që janë kundër ndarjeve të Kosovës, gjithçka tjetër është e mundur.

## FAKTE RELEVANT PËR HETIM OBJEKTIV

Shumë nervozë dhe aluzione në adresë të gabuar kishte nga Beogradi zyrtar në stilin e përrallës popullore kur ujkua duke qëndruar më lartë i thotë deles: 'dele pse ma turbullon ujin!' Çdo hetim dhe aluzion ose fajësim të autoriteteve kosovare, është jashtë çdo logjike. 1. Vrasja ka ndodhur në pjesën veriore të Mitrovicës, që e kontrollojnë struktura paralele dhe grupe kriminale. Çdo përpjekje të deritashme të autoriteteve kosovare për ta bashkuar Mitrovicën dhe për ta vendosur pushtetin ligjor, ka hasur në rezistencë të serbëve të Mitrovicës dhe nga vetë Beogradi zyrtar. 2. Këmba e shqiptarit në këtë pjesë ka shkelur vetëm në raste vizitash delegacionesh, të kontrolluara nga forca ndërkombëtare. 3. Hetimin në të cilin kërkohet të marrë pjesë Serbia, mund ta bëjë në mesin e serbëve të Mitrovicës dhe fajin ta gjejë në mesin e tyre. 4. Pyetja kyç e hetimit duhet të jetë: KUJT I Përgjigjet VRASJA e Oliver Ivanoviqit? Logjika thotë: sigurisht JO Kosovës..., shkruan publicisti Daut Daut nga Shkupi.

## PESHQIT E MËDHENJ TË KRIMIT

"Edi Rama ka propozuar një ligj të posaçëm, i propozuar gjoja si ndryshim i rregullores, por është një ligj i posaçëm për të mbrojtur peshqit e mëdhenj. Të gjithë ata që prisnin arrestimin dhe vënien para drejtësisë të peshqve të mëdhenj, tani duhet të kënaqen me cironka. Ligji propozon që Prokuroria të paraqesë provat në Kuvend dhe gjyqtari të jetë Edi Rama. Kjo do ta kthejë SPAK-un në një organizatë joqeveritare, sepse gjithë pushteti për të vendosur nëse politikanët e korruptuar do të paraqiten para drejtësisë apo jo, do të jetë i mazhorancës, i Edi Ramës", shkruan kryetari i PD-së së Shqipërisë, Lulzim Basha.

## HETIMET SERBE NË KUADËR TË LICJEVE TË KOSOVËS

"Sot zhvillova një bisedë telefonike me Presidentin e Republikës së Serbisë, z. Aleksander Vuçiq. Në këtë bisedë telefonike, trajtuam çështjet e ndryshme të interesit të përbashkët, duke u fokusuar në domosdoshmërinë e vazhdimin të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve ndërshtetërore, forcimin e paqes në rajon dhe perspektivën e integritetit euro-atlantik. Një çështje e veçantë, e cila u diskutua ishte edhe vrasja e djeshme e kryetarit të Iniciativës Qytetare 'Liria, Demokracia, Drejtësia' (SDP) Oliver Ivanoviq. Lidhur me këtë çështje, sigurova Presidentin Vuçiq se organet përgjegjëse të prokurorisë dhe policisë janë duke bërë hetime intensive për zbulimin dhe sjelljen përpara drejtësisë të atyre që e kanë bërë këtë vrasje. Sigurova gjithashtu theksoi se, organet kompetente të Republikës së Kosovës janë të gatshëm që në përputhje me legjislacionin në fuqi, të bashkëpunojnë dhe të pranojnë çfarëdo ndihme, e cila mund të çojë drejt zbardhjes së kësaj vrasjeje. Të dy theksuam domosdoshmërinë që t'u jepet kohë e mjaftueshme që organet kompetente të kryejnë punën e tyre në mënyrë profesionale dhe të pavarur. Ajo çfarë është kryesore në gjithë këtë çështje, është zbulimi i kryesve të kësaj vrasjeje...", shkruan në profilin e tij zyrtarë në FB, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi.

## MEDIACitate

Atentati ndaj Oliver Ivanoviq seriozisht e ka vënë në pyetje dialogun ndërmjet Beogradit e Prishtinës, ka vlerësuar ish-emisari i BE-së për Kosovën Wolfgang Petritsch. Petritsch në një bisedë për gazetën vjeneze "Die Presse", ka thënë se e ka goditur shumë vrasja. "E kam njohur Ivanoviqin, sigurisht në fazën më të vështirë të konfliktit të Kosovës, si një njeri të mençur, njëri nga të rrallët në anën e Milosheviqit i cili sinjerisht luftonte për zgjidhjen e problemit të shumicës shqiptare. Nuk dëshiroj të spekuloj për prapavijën, por atentati e ka vënë seriozisht në pyetje dialogun", ka sqaruar ai.

(Koha DITORE, 18 janar)

Për të tretën herë, Kryesisë së Kuvendit të Kosovës i ka dështuar mbledhja, ku pritej të diskutohet për shfuqizimin e Gjykatës Speciale. Kjo për faktin se kishte mungesë kuorumi. Reagim të ashpër kundër kësaj iniciative edhe dje pati nga ambasadori amerikan Greg Delawie. Kryesia e Kuvendit ka dështuar edhe gjatë ditës së djeshme ta mbajë mbledhjen, ku pritej të diskutohet për shfuqizimin e Gjykatës Speciale. Në mungesë të kuoromit kryetari i Kuvendit, Kadri Veseli, ka mbyllur mbledhjen (e cila nisi me një orë vonesë), duke thënë se atë do ta thërrasë për javën tjetër. Kryekuvendari kishte thirrur mbledhje edhe në natën e 22 dhjetorit, porse në mungesë të numrave kishte dështuar dy herë radhazi.

(Zëri, 18 janar)

Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, përmes një komunikate për media ka reaguar lidhur me zhvillimet e fundit pas vrasjes së politikanit serb, Oliver Ivanoviq. KMDLNJ ka kujtuar akuzat për krime lufte që rëndonin ndaj Ivanoviq, përderisa e ka cilësuar si të papranueshëm propozimin që një delegacion i Kuvendit të Kosovës të marrë pjesë në varrimin e tij. Ky institucion ka kërkuar drejtësi për viktimat, në rastin konkret për 49 viktimat shqiptare. "Për Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut nuk ka pasur asnjë mëdyshje për të kaluarën e tij kriminale dhe për përgjegjësinë komanduese për krime lufte ndaj civilëve të pafajshëm shqiptarë, boshnjakë dhe turq", thonë nga KMDLNJ.

(Klan Kosova, 18 janar)

## NËSE NUK E KENI DITUR...

### KUSH ISHTE GJERGJ QIRIAZI?

Gjergj Qiriaz (1865-1912) ishte veprimtar i Rilindjes Kombëtare, publicist. Ishte sekretar dhe nënkryetar i klubit shqiptar "Bashkimi" të Manastirit, ku luajti rol sidomos për organizimin dhe zhvillimin e punimeve të Kongresit të Manastirit (1908). Pas vdekjes së Gjerazim Qiriazit ai qe ndihmësi kryesor për mbajtjen në këmbë të shkollës shqipe të vajzave në Korçë. Gjergj Qiriaz dha ndihmë të



shk. XIX. Botoi një "Hristomathi" në dy vëllime me pjesë letrare didaktike. Gjergj Qiriaz bashkëpunoi në disa organe të kohës. U interesua në veçanti për dorëshkrimet e K. Kristoforidhit.

rëndësishme për përgatitjen e teksteve shkollore. Është autori i parë i tekstit të mirëfilltë të fizikës në gjuhën shqipe, me të dhënat më të reja në fushën e fizikës të

Sekretari përgjithshëm i NATO-së, Jens Stoltenberg, pas takimit që pati me kryeministrin Zoran Zaev dhe zyrtarët tjerë shtetëror, përsëriti se organizata që drejton ai, nuk ka një plan B për anëtarësim në NATO nëse vonohet zgjidhja e çështjes së emrit me Greqinë

STOLTENBERG TAKIM ME AUTORITETET MË TË LARTA SHTETËRORE

# EMRI, PASTAJ NË NATO



**STOLTENBERG TAKOHET ME JANEVËN**  
Prokurorja Publike Speciale, Katica Janeva sot realizoi takim me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, në kuadër të vizitës së tij në Republikën e Maqedonisë. Në takim, siç kumtoi PPS, Janeva e informoi Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s Stoltenberg se Prokuroria Publike të cilën e drejton ajo ka përgjegjësi institucionale për hetimin e veprave penale të cilat lidhen dhe të cilat dalin prej përmbajtjes së ndjekjes së paligjshme të komunikimeve dhe se është vendimtare për ta plotësuar qëllimin për të cilin është formuar. Janeva në takim ka theksuar se puna e kësaj Prokurorie Publike është me rëndësi të jashtëzakonshme për sigurimin e qeverisjes së drejtës dhe kthimin e besimit të qytetarëve në institucionet e shtetit, si një prej parakushteve kryesore për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë në NATO.

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 18 janar - Sekretari i përgjithshëm i NATO-s, Jens Stoltenberg, të enjten gjatë vizitës zyrtare në Maqedoni kishte takime me autoritete më të larta shtetërore, ndërkaq në mesditë me fjalim iu drejtua deputetëve të Parlamentit të Maqedonisë. Mesazhi që dha Stoltenberg para deputeteve ishte se Maqedonia i ka dyert e hapura për në NATO, siç tha ai, në organizatën më të suksesshme ushtarake në botë. Por, sipas Stoltenberg, krciale për Maqedoninë është zgjidhja e kontestit të emrin me shtetin fqinj Greqinë, duke kërkuar kyçjen në këtë proces të të gjitha palëve. Stoltenberg përkujtoi para deputetëve se para 9 muajve, Maqedonia nuk ishte shtet stabil dhe tani, siç u shpreh ai, me përkushtimin e Qeverisë, Maqedoni tani është shtet stabil. Në këtë vijë, Stoltenberg tha se nëse vazhdohet kështu - Maqedonia i ka dyert e hapura për në NATO. Të pranishëm në seancë ishin edhe deputetët e VMRO-së, mes të cilëve dhe ish-kryeministri Nikolla Gruevski, presidenti Ivanov, kryeministri Zoran Zaev dhe të gjithë ministrat e kabinetit qeveritar, krerët e bashkësive fetare, Avokati i Popullit, Ixhet Memediti dhe kreu i Gjykatës Kushtetuese.

## TË PËRKUSHTUAR NË BALLKANIN PERËNDIMOR

"Kam kënaqësinë që jam para jush sot këtu. Ju faleminderit kryetar për ftesën që tu drejtohem deputetëve. Faleminderit për përkushtimet e juaja për sigurinë nëpër botë. NATO është Aleanca më e suksesshme ushtarake në histori. Ne jemi shumë të përkushtuar në Ballkanin Perëndimor, dhe dëshirojmë që sa më shpejtë Maqedonia të jetë pjesë e jona, të jetë një shtet me prosperitet, siguri dhe stabilitet. Përsëritim punën e Qeverisë së Maqedonisë dhe përkushtimin e saj që sa më shpejtë të anëtarësohet në NATO. Keni edhe shumë punë për të bërë, duhet të zgjidhni çështjen e emrit. Duhet të keni marrëdhënie të mira me fqinjët tuaj, dhe në këtë aspekt e përsëritim fuqishëm ratifikimin e Marrëveshjes me Bullgarinë. Raundi i ri i bisedimeve që filloi dje në Nju Jork është një hap shumë i

rëndësishëm. Me rëndësi të veçantë është edhe roli i opozitës në vendin tuaj, sepse ajo duhet ta korrigjojë Qeverinë. Para nëntë muajve, Maqedonia ishte një shtet jo stabil, por me përkushtimin e Qeverisë së re, tanimë Maqedonia është një shtet stabil dhe nëse vazhdon kështu, ajo i ka dyert e hapura për në NATO", tha mes tjerash Stoltenberg. Ai mori shembullin e Malit të Zi që, siç tha Stoltenberg, është e barabartë me të gjitha shtete tjera anëtare dhe njëjtë, tha ai, dëshiron ta shohë dhe Maqedoninë. Mes tjerash, sekretari i përgjithshëm i NATO-s përgëzoi Qeverinë për reformat e nisura dhe Ligjin për gjuhët. "Mali i Zi është anëtarja e 29 e Aleancës. Me votë dhe të drejta të barabarta sikurse të gjitha anëtarët e tjera. Duke parë se si flamuri i Malit të Zi u ngrit për herë të parë gjatë vitit të kaluar, për mua ishte një moment krenarie. Ka akoma vend për flamuj të ri në Selinë e NATO-s. Dëshiroj që edhe ju të arrini sukses. Është mirë të jeni ambicioz, por është rëndësishme që të jeni edhe real. Duhet edhe shumë punë për tu bërë, kjo nënkupton edhe zgjidhjen e çështjes së emrit. Kjo është një çështje që rëndon këtë vend dhe rajonin tanimë një kohë të gjatë. Prej këtu përshëndes vullnetin e kësaj Qeverie për përkushtimin për zgjidhjen e kësaj çështje. Dje në Nju Jork u bë edhe një hap i madh, jam i inkurajuar për hapat e

ndërmarrja dhe ju inkurajoj të shkoni para. Megjithatë, anëtarësimi në NATO është më shumë se zgjidhja e çështjes së emrit. Vendet aspirante për anëtarësim në NATO duhet të përmbushin edhe reformat. Ju përgëzoj për përpjekjet, posaçërisht Planin 3-6-9. Miratimi i Ligjit për gjuhët ishte një hap i rëndësishëm. Që të keni sukses është i nevojshëm konstruktiviteti i opozitës dhe i shoqërisë qytetare", deklaroi Stoltenberg para deputetëve. Më pas, ai pati talim me liderin e VMRO-së, Hristijan Mickovski, ndërsa për rrjedhën e takimit foli koordinatori i përkohshëm i grupit parlamentar Vllatko Gjoçev. Siç tha Gjoçev, delegacioni i VMRO-se në krye me kryetarin Mickovski, sekretarit të përgjithshëm të NATO-s i kanë shprehur qëndrimin se Maqedonia është i vetmi vend në Evropë në të cilin ka përndjekje politike referuar deputetëve të burgosur nga kjo parti. Duke iu përgjigjur pyetjeve të gazetarëve nëse VMRO ka vërejtje për procesin negociator që aktualisht po zhvillohet në Nju Jork të SHBA-së, Gjoçev tha se është shqetësuese deklarata e fundit e kryenegociatorit të Maqedonisë, Vasko Naumosvki, lidhur me propozimin e ndërmjetësuesit Metju Nimiç. Por, ndryshe nga Gjoçev, kryetari i BDI-së, Ali Ahmeti, ishte kritik ndaj deklaratës së Vasko Naumosvkit pa u konsultuar me Qeverinë.

## TË BRENGOSUR ME NAUMOVSKIN

"Më brengosi brengosja e përfaqësuesit të Maqedonisë. Ai deklarata e tij i ka bërë pa mos e konsultuar ligjvënësin dhe pa mos konsultuar institucionet vendim-marrëse. Nuk është ai qëndrimi i shtetit", u shpreh Ali Ahmeti. Ndërsa në lidhje me takimin që pati me sekretarin Stoltenberg, kreu i BDI-së tha se e kanë ngritur çështjen e anëtarësimit të Maqedonisë në NATO si vullnet jo vetëm i partisë së tij, por edhe i gjithë komunitetit shqiptar. Sipas Ahmetit, ky anëtarësim do të sjellte stabilitet afatgjatë në rajon. "Me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s biseduam për zhvillimet në rajon, ai përcolli porosin e Aleancës që ai përfaqëson lidhur me situatën në rajon. Ne ngritëm çështje shumë sipërfaqësore sa i takon vullnetit tonë si parti politike dhe qytetarëve të Maqedonisë për anëtarësimin e vendit tonë në NATO, si një proces shumë të rëndësishëm për përfortimin e paqes, stabilitetit në vendin tonë, por në përgjithësi edhe në mbarë rajonin", deklaroi Ali Ahmeti. Nga LSDM doli koordinatori i Grupit parlamentar, Tomislav Tuntev, ndërsa tha se sekretari Stoltenberg u ka apeluar gjatë takimit me kryeparlamentarin Talat Xhaferi që në procesin e reformave dhe anëtarësimin në NATO të kyçen të gjitha palët. Paraprakisht, Jens Stoltenberg pati takim me ministrin e Punëve të Ja-

## AHMETI: LIRIA JONË NUK ËSHTË E PLOTË PA NATO-N

Liria jonë nuk është e plotë pa NATO-n, brezat e ardhshme duhet të jenë falënderues dhe ta vlerësojnë Aleancën, konsideron kryetari i Bashkimit Demokratik për Integritim, Ali Ahmeti, në takimin e djeshëm me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg dhe bashkëpunëtorët e tij nga aleanca veriatlantike. Ahmeti tha që NATO ka patur rol vendimtar në vend e rajon dhe ka shpëtuar Maqedoninë nga gremina duke kontribuar në

paqen, sigurinë dhe stabilitetin, por edhe në reformat dhe institucionet demokratike të vendit. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Stoltenberg, siç citohet në njoftimin e BDI-së, tha që roli personal i Ahmeti dhe i BDI-së është shumë i rëndësishëm dhe e falënderoi atë për kontributin në të gjitha proceset në vend. Stoltenberg theksoi që dera e NATO-s mbetet e hapur dhe na inkurajoi që të adresojmë reformat dhe çështjen e emrit.

shtme, Nikolla Dimitrov. Dimitrov ka theksuar se vizita e Sekretarit gjeneral të NATO-s është me rëndësi krciale për Maqedoninë dhe është motiv i fuqishëm për hapat e vendit që viti 2018 të jetë vit historik për vendin dhe regionin. "Stoltenberg e ka vërtetuar politikën e dyerve të hapura të NATO-s, gjithashtu ka shprehur mbështetjen për reformat, duke bërë thirrje që të shfrytëzohet momentum i pozitiv për realizimin e plotë të aspiratave euroatlantike të Maqedonisë", theksuan nga Ministria e Punëve të Jashtme. Në lidhje me çështjen e emrit, dy ditë më parë diplomati maqedonas Vasko Naumosvki tha se ndërmjetësuesi Nimiç ka propozuar disa ide të cilat, sipas tij, janë larg zgjidhjes dinjitoze. "Nga ndërmjetësuesi na u prezantuan disa ide për të cilat vlerësoj se dalin në kuadër të kësaj kornize dhe se janë larg zgjidhjes dinjitoze, por sërish këto propozime do t'ju prezantohen faktorit politik dhe shtetëror dhe të njëjtët do të marrin qëndrim në lidhje me këtë çështje", tha Naumosvki.

DHURATA HOXHA VIZITON SHKUPIN

# PËRVOJAT E MAQEDONISË PËR INTEGRIM MË TË SHPEJTË NË BE

"Maqedonia tashmë 17 vjet bisedon dhe punon në implementimin e Marrëveshjes për Stabilizim dhe Asocim dhe i ka akumuluar përvojat dhe njohuritë që mund t'ua transferojë shteteve në rajon që të lehtësohet rruga e tyre në drejtim të BE-së", porositi zëvendëskryeministri Osmani pas takimit me ministren e Integritimeve Evropiane të Kosovës, Dhurata Hoxha



ga jonë, sepse, siç tha, së bashku shumë më shpejt përparojmë. "Si shtet dhe rajon ndodhemi në një vit historik dhe para ngjarjeve historike. Në shkurt do të publikohet Strategjia për zgjerim të Bashkimit Evropian, e para e këtij lloji, e cila i jep perspektivë rajonit për anëtarësim në BE. Për këtë është me rëndësi si vende të Ballkanit Perëndimor të jemi të koordinuar që të jemi pjesë nga kjo strategji e cila do ta konfirmojë perspektivën afatgjatë të vendeve. Krahas kësaj, këtu është edhe Samiti i majit në Sofje në të cilin duhet të betonohet perspektiva e vendeve nga Ballkani Perëndimor", tha Osmani. Ai theksoi se secili vend duhet ta realizojë pjesën e vet të detyrave përmes përpjekjeve individuale, ndër-

sa ai proces, siç tha, mund të lehtësohet përmes bashkëpunimit rajonal. Përkujtoi se para pak kohe është takuar me kolegun shqiptar Bushatin dhe shtoi se së shpejti do të ketë edhe takim me ministren serbe për çështje evropiane. Krahas përfitimeve nga shkëmbimi i përvojave të ndërsjella, në takim u hapën edhe tema për aktivitetet e deritanishme në kuadër të bashkëpunimit rajonal, në veçanti në kontekst të bashkëpunimit rajonal në kuadër të fondeve të BE-së si dhe për projektet e përbashkëta në kuadër të Procesit të Berlinit. "Përkundër marrëdhënieve të afërta dypalëshe, Maqedonia dhe Kosova kanë orientim të njëjtë euro-atlantike, nga e cila dalin sfida të përbashkëta rajonale por

edhe evropiane. Dy vendet janë vende të vogla, pa dalje në det, progresi i të cilëve varet nga sukcesi i bashkëpunimit rajonal, por edhe integrim në sistemet e mëdha siç janë Bashkimi Evropian dhe NATO", theksoi Osmani. Ministria e Integritimeve Evropiane të Kosovës theksoi se ky vit është shumë i rëndësishëm për të gjitha vendet e rajonit dhe shtoi se duhet të shfrytëzohet në mënyrë racionale. "Vendi i shteteve të Ballkanit Perëndimor është në BE dhe për këtë duhet sa më shumë ta shfrytëzojmë bashkëpunimin rajonal. Ka shumë gjëra të cilat mund t'i marrim nga Maqedonia, siç janë përkthimi i legjislacionit dhe koordinime të tjera të ndryshme", tha Hoxha.

## TË ZHĜËNJYER NGA VENDIMI I IVANOVIT

Mosnëshkrimi i Ligjit për përdorimin e gjuhëve nga ana e presidentit të Maqedonisë, Gjorge Ivanov, nuk është e papritur për zëvendëskryeministrin për Çështje evropiane, Bujar Osmani edhe pse, siç thotë, është i zhgënjyer nga veprimi. "Jemi të zhgënjyer edhe pse jo që nuk pritej, por megjithatë mendojmë se do ta shfrytëzojmë momentin", tha Osmani në përgjigjen në pyetjen e gazetarëve pas takimit me ministren për Eurointegritime të Kosovës, Dhurata Hoxha në ambientet e SÇE. Ai theksoi se presidenti duhet të jetë qendër kohezive e shoqërisë, i cili duhet t'i bashkojë komunitetet etnike dhe grupet e ndryshme shoqërore. "Këtë rol nuk e ka luajtur në tetë deri në nëntë vitet e fundit. Pati mundësi që këto ditë në vitin e tij të dërgojë porosi të kohezionit dhe unitetit, si dhe për hapjen e perspektivës së shtetit, por është e qartë se nuk mund të dalë nga

matrica e tij e funksionimit. Ndërkaq, edhe krahas kësaj që na zhgënjoi, nuk na brengos, sepse sërish do ta votojmë ligjin në Kuvend ditëve në vijim", deklaroi Osmani. Ministria e Kosovës Hoxha theksoi se vendi i tyre tashmë ka tre gjuhë zyrtare - shqipen, serbishten dhe turqishten. "Këto gjuhë gjithmonë përdoren si zyrtare. Mendoj se është shumë me rëndësi për integrimin evropian që në secilin vend secili komunitet të mund ta përdorë gjuhën e tij amtare", tha Hoxha. Presidenti Ivanov dje bëri të ditur se nuk do ta nënshkruajë dekretin për shpalljen e Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Vlerësoi, mes tjerash, se me këtë ligj vendoset një paralelizëm shumë i shtrenjtë në të gjitha organet e pushtetit shtetëror dhe se në kushte të bllokimit ekziston rrezik të hapet çështja për ridefinimin kushtetues dhe cenimin e unitaritit, sovranitetit dhe integritetit territorial të RM-së.

## Edhe Bullgaria e ratifikoi Marrëveshjen me Maqedoninë

Sofje, 18 janar - Parlamenti i Bullgarisë të enjten unanimisht e ratifikoi Marrëveshjen për fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim me Maqedoninë. Marrëveshja mori mbështetje nga të gjitha partitë parlamentare në seancat e djeshme të komisioneve për politikë të jashtme dhe për çështje evropiane. Marrëveshja, siç njofton MIA është nënshkruar më 1 gusht të vitit 2017 nga ana e kryeministrit të dy shteteve, Zoran Zaev dhe Bojko Borisov, për shkak të përfundimit të marrëdhënieve të ndërsjella miqësore, avancimit të fqinjësisë së mirë, zhvillimit të marrëdhënieve të gjithanshme të ndërsjella, konform të drejtës ndërkombëtare. Kjo është rezultat i procesit negociues pesëvjeçar të grupeve të punës të dy MPJ-ve, dhe paraqet sendërtim të marrëveshjes të nënshkruar në vitin 1990. Më 15 janar, Kuvendi i Maqedonisë me 61 vota "pro" dhe një "abstenim" e votoi Propozim ligjin për ratifikim të Marrëveshjes për miqësi, fqinjësi të mirë dhe bashkëpunim mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Bullgarisë.

## Zgjidhje pa fitues ose humbës



Athinë, 18 janar - Qeveria dëshiron dhe do të bëjë gjithçka që është e mundur që të zgjidhet problemi me emrin e IRJM-së pa i venë në rrezik interesat nacionale, thotë zëdhënësi i qeverisë greke, Dimitris Xanakopoulos. Në intervistën për radion "24/7", njofton korrespondenti i MIA-s nga Athina, ai sqaron se negociatat nuk janë ndeshje futbollit që të ketë fitues ose humbës. "Duam zgjidhje në të cilën të gjithë do të jemi fitues", tha Xanakopoulos. Zëdhënësi i qeverisë greke, në intervistën për radion, e përsëriti pozicionin grek për emër të ndërlikuar për përdorim të përgjithshëm. Gazeta greke "Etnos", sot publikoi se ndërmjetësi Nimic, ka parashtruar set idesh dhe propozimesh në gjuhën maqedonase dhe angleze. Gazeta, duke iu referuar informacioneve të saj, pohon se në të gjitha propozimet është i kyçur termi Maqedoni, ndërsa mes emrave të mundshëm "Etnos" i publikon: "Novamacedonia", "Uppermacedonia" dhe "Northern Macedonia".

## Qeveria do ta analizojë kornizën e propozuar nga Nimici

Shkup, 18 janar - Në OKB krijohen kushte për lëvizje përpara të procesit për zgjidhjen e çështjes së emrit, ndërsa verdikti do të varet nga gatishmëria për kompromis të dy palëve, vlerësohet në kumtesën e Qeverisë së Maqedonisë pas raundit të ri të bisedimeve në Nju Jork të ndërmjetësit Methju Nimic me

përfaqësuesit e Maqedonisë dhe të Greqisë, Vasko Naumovski dhe Ademantios Vasilakis. Pas një analize të vëmendshme të kornizës së Nimicit që e ka prezantuar para negociatorëve në Nju-Jork, nga Qeveria paralajmërojnë se në pajtim me rëndësinë e çështjes për interesa shtetërore, do të vazhdojë

procesi për ndërtimin e qëndrimit sa më të gjerë të mundshëm dhe më inkulziv nga ana e Republikës së Maqedonisë. "Qeveria e Republikës së Maqedonisë është e përkushtuar në zgjidhjen e kontestit të cilin Republika e Greqisë e ka me emrin kushtetues të Republikës së Maqedonisë. Në mënyrë

aktive krijohen kushte për lëvizjes së procesit përpara, ndërsa epilogu do të varet nga përgatitja për kompromis të dy palëve, duke pasur parasysh dallimet. Lë përshtypje të mirë komunikimi i ripërtërirë, e cila hap hapësirë për qasje miqësore dhe ndërtim të besimit të ndërsjellë", thuhet në kumtesë.

## PROCESET "TRUST" DHE "TARGET-FORTESA"



# PSP FILLOI ME ANULIME TË PROCESSEVE

Për dallim nga lëndët tjera të iniciuara nga PSP-ja, pranë GJPSH-së, rasti "Trust", vitin e kaluar u zhvilluar deri në një fazë kur edhe u prezantuan materiale të pa publikuar deri më tani e që burojnë nga përgjimet e jashtëligjshme. Megjithatë, për shkak të sistematizimit të ri të gjykatësve, edhe ky proces nga java e ardhshme pritet të filloi nga e para

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 18 janar - Pritjet e opinionit se me fillimin e vitit të ri do të fillojnë të procedohen edhe lëndët e Prokurorisë Speciale Publike, si duket nuk po realizohet. Kjo, pasi të mërkurën, në Gjykatën Penale të Shkupit u shty sërish seanca gjyqësore për rastin "Target-Fortesa", një situatë e ngjashme u përsëritin edhe për lëndën "Trust", me çka e njëjta u anulua për datë 23 janar. Shkaku kryesor se pse kësaj radhe nuk u zhvillua procesi gjyqësor për këtë lëndë, ishte mungesa e të akuzuarit të dytë, në këtë rast të dyshuarit Vasilije Aviroviq. Përkeqësimi i gjendjes shëndetësore të Aviroviqit, si arsye e vetme e paraqitur, rezultoi me shtyrjen e seancës për javën e ardhshme. Në rastin "Trust", i akuzuar i parë ngarkohet afaristi i mirënjohur, Sead Koçan, i cili së bashku me të akuzuarin e tretë, Safet Vatiq dhe përfaqësuesin ligjor të kompanive "Transmet", "Sileks" dhe "Vato", të enjten u paraqitën në gjykatë.

Për dallim nga lëndët tjera të iniciuara nga PSP-ja, pranë GJPSH-së, rasti "Trust", vitin e kaluar u zhvilluar deri në një fazë kur edhe u prezantuan materiale të pa pu-

blikuar e që burojnë nga përgjimet e jashtëligjshme. Megjithatë, për shkak të sistematizimit të ri të gjykatësve, edhe ky proces nga java e ardhshme pritet të filloi nga e para. Në seancën gjyqësore e cili u zhvilluar me 22 dhjetor të vitit të kaluar, opinioni pati mundësi t'i dëgjoj tri bisedat e ish funksionarëve të lartë të shtetit e të cilat lidhen me trukimin e tenderit milionësh, të cilën kompania e Sead Koçanit e kishite fituar në vitin 2011. Pjesë e tri "bombave", tashmë dëshmi materiale kundër të akuzuarve në rastin "Trust", janë ish Sekretari i Qeverisë, Kirill Bozhinovski dhe ish drejtori i ELEM-it, Vllatko Çingovski. Dhe, në bisedën e tretë, opinioni pati rasti të dëgjoj bisedën mes ish kryeministrit, Nikolla Gruevski dhe ish drejtorit Çingovski. Biseda mes Bozhinovskit dhe Çingovskit, zhvillohet në drejtim të arritjes së marrëveshjes për fitimin e tenderit nga konzorciumi i kompanive (Transmet-Sileks-Vato).

"Kushtet duhet të jenë ashtu siç ju konvenon atyre", kështu i drejtohet ish Sekretari i Qeverisë, Kirill Bozhinovski, drejtorit të atëhershëm të ELEM-it, Vllatko Çingovski. Këto biseda, siç kanë njoftuar nga PSP-

ja, janë zhvilluar gjatë vitit 2011, respektivisht në këtë rast janë përdorur shifra gjatë komunikimit, të llojit "vëllai nga jugu", "bitollçanecot" apo "kratovecot", duke aluduar në drejtorin dhe një pjesë të të akuzuarve. Detaj tjetër i rëndësishëm i kësaj bisedë është përgjigja e drejtorit Çingovski, tek thoshte se është takuar me përfaqësuesit e konzorciumit dhe janë arritur marrëveshje për kushtet e tenderit. Ndryshe, në bisedën e vetme ku është i përfshirë ish kryeministri, Gruevski, në këtë rast, opinioni pati mundësi të dëgjoj se ai e njoftonte drejtorin Çingovski, i cili ka pasur takim me personin që ngiste automobil "seat ibica".

Biseda tjera të kësaj natyre, opinioni dhe gazetarët, gjithsesi do të kenë mundësi t'i dëgjojnë në ndonjërin prej gjykimeve të ardhshme, të iniciuara nga PSP-ja. Për muajin janar dhe shkurt pranë GJPSH-së, janë paraparë të zhvillohen një sërë seancash gjyqësore, të iniciuara nga PSP-ja. Megjithatë mbetet të shihet nëse deri më 12 shkurt, kur edhe pritet të filloi rigjykimi për "Monstrën", Prokuroria Special do ta kërkojë zyrtarisht lëndën për vrasjen e pesëfishtë që ndodhi në vitin 2012 në Liqenin e Smilkovës në Shkup.

## Keqpërdorime të shumta në "Parkingje dhe gjelbërim"

Costivar, 18 janar - Të punësuar në NP "Parkingje dhe gjelbërim" dhe pushteti lokal i Costivarit në konferencë për shtyp publikuan keqpërdorime të cilat, siç theksuan, i ka bërë udhëheqësia e kaluar. Në kuadër të fushatës "E vërteta për BDI-në", të cilën e inicoi kryesia aktuale e komunës, të enjten u prezantuan hollësi rreth punës financiare të kësaj ndërmarrjeje publike. "Në bazë të revizionit të brendshëm në këtë ndërmarrje, janë konstatuar disa shkelje

dhe parregullsi procedurale. Ndërmarrja është lënë në borxh, shuma e të cilit tejkalon pesë milionë denarë. Tatimi personal i rrogave nuk është paguar prej janarit deri në shtator të vitit 2017. Buxheti i ndërmarrjes çdo muaj është dëmtuar me rreth 5000 euro. Ato para kanë shkuar në llogari të ndërmarrjes me të cilën është lidhur kontratë për parkim të zonës, ndërsa kjo është në kundërshtim me kontratën. Në vend se ndërmarrja të paguajë

neto shumë siç qëndron në kontratë, është paguar bruto, për cilat shkaqe nuk e dimë", tha zëdhënësi i NP "Parkingje dhe gjelbërim", Rasim Abdul. Abdul theksoi se në parkingjet e tipit të mbyllur është punuar me bileta në dorë dhe pa llogari fiskale. Sa për krahasim, të hyrat mujore nga këto parkingje kanë qenë me një mesatare prej 15.000.00 denar, ndërsa tani gjithçka është e fiskalizuar dhe të hyrat reale të atij parkingu janë me sa vijon: Nga 16 nënto-

ri, dmth në gjysmën e dytë të muajit kur detyrën e mori udhëheqësia e re aktuale, janë regjistruar të hyra 33.000.00 denarë, për muajin Dhjetor 100.000.00 denarë dhe deri këto dy javë të para të janarit më datë 16.01.2018 është 129.290.00 denarë, që nënkupton se të ardhurat janë ritur për 660%. Ai thotë se mbetet ish drejtorit që të japë sqarim për se të hyrat kanë qenë aq të ulëta përderisa kapaciteti real i atyre parkingjeve flet ndryshe.

## KRONIKË

### Resnjë, tre të lënduar, prej të cilëve dy fëmijë

Në aksidentin rrugor që ka ndodhur dje rreth orës 14:15 në rrugën lokale për në fshatin Dollna Bella Cërkuva - Resnjë janë lënduar tre persona, prej të cilëve dy fëmijë. Siç është theksuar në buletin e policisë, aksidenti ka ndodhur ndërmjet makinës "Mercedes" me targa të Ohrit, të drejtuar nga Xh.M. (46) nga fshati Jankovec, në rajonin e Resnjës dhe makinës "Jugo" me targa të Ohrit të drejtuar nga B.T. (62) nga Resnja. Rëndime të rënda trupore kanë marrë B.T. një djalosh tetëvjeçar dhe një vajzë dyvjeçare. Të gjithë janë mbajtur për kurim në Spitalin në Manastir. Ekspertizë në vendin e ngjarjes ka kryer ekipi i Zyrës së jashtme për punë krimilantike nga Resnja.

### Zjarr në tri shtëpi, nuk ka të lënduar

Një zjarr shpërtheu në mëngjesin e djeshëm në shtëpitë në pronësi të M.D. (51), të V.A. (43) dhe të N.Z. në Resnjë në të cilin janë përfshirë konstruksionet e çative, dhomat dhe orenditë, ndërsa gjatë shuarjes së tij janë dëmtuar një pjesë e mureve dhe orendive. Në zjarrin nuk ka të lënduar. Zjarri ishte shuar nga ekipi i Njësisë Zjarrfikëse Teritoriale. Ekspertizë ka kryer ekipi i Zyrës së jashtme për punë krimilantike Resnjë. Zjarri, siç kumtoi MPB, me siguri ka ndodhur në çati, gjegjësisht në oxhakun e shtëpisë së M.D.

### Shkup, 12 aksidente me dy të lënduar

Dy persona janë lënduar më lehtë në dy nga gjithsej 12 aksidente rrugore të regjistruara gjatë ditës së djeshme në rajonin e SPB Shkup. Në 10 është shkaktuar dëm material. Nga MPB informojnë se dje policia e trafikut ka zbuluar dhe sanksionuar shumë kundërvajtje. Tetë shoferë kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe se e lejuara, tre shoferë kanë kaluar në udhëkryq në dritën e kuqe të semaforit dhe dy shoferë nuk ju kanë dhënë përparësi kalimi këmbësorëve. Nga komunikacioni janë përjashtuar një shofer, i cili e ka drejtuar automjetin në ndikimin e alkoolit, 12 shoferë para se të marrin leje për drejtim të automjetit dhe dy shoferë fillestar, si dhe 11 automjete të paregjistruara. U sanksionuan edhe katër këmbësorë të cilët kanë kaluar rrugën jashtë vendkalimit për këmbësorë. Janë hasur 49 automjete të parkuara në mënyrë të parregullt. Me ndihmën e automjetit special karrotrec, janë larguar 44 automjete.

### Plaçkitje në një kazino në Shkup

Një person i panjohur i maskuar të mërkurën mbrëma ka kryer plaçkitje ndaj të punësuar në një kazino që ndodhet në rr. "11 Tetori" në Shkup, me ç'rast me kërcënim me pistoletë ia ka marrë paratë nga qarkullimi ditor. Pas vjedhjes kryerësi ka ikur. Po ndërmerren masa për gjetjen e kryerësit dhe për zbardhjen e plotë të rastit. (O.Xh)

DEBAT PËR PROPOZIM-LIGJIN PËR ARSIM TË LARTË NË AMSHA

# LIGJI NUK PËRMBUSH AS PRITJET MINIMALE

“Në fillim duhej të diskutim për reforma në arsimin e lartë, duhej të përpilohej një Strategji, të hartohej Plani operacional për zbatimin asaj reforme dhe pastaj të nxirrej Ligji për arsim të lartë”, vëren udhëheqësi i Qendrës për hulumtime strategjike të AMSHA-së, akademik Vllado Kambovski. Maqedonia, sikurse pohon ai, është vendi i vetëm i rajonit që nuk ka ende një Strategji për arsim të lartë



ve Këshillit për Akreditim, këshillit nacional të Arsimit të Lartë. Nuk përcakton mirë konceptin e financimit të universiteteve, kërkimeve shkencore, pozitën e organizatave studentore dhe nuk është në frymën e përgatitjes së gjeneratave të afta për tregun e punës. Akademikë, pedagogët universitar dhe përfaqësues të lidhjes së filozofëve kanë vërejtje të shumta për mungesën e modelit të një universitet bashkëkohor, të integruar si dhe mungesën e frymës progresiste që do të duhej ta karakterizonte Ligjin e ri. Për kryetarin e AMSHA-së, Taki Fitin, Propozim-ligji që ka nxjerrë për debat Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) nuk përmbush as komponentin minimale, pra nuk arrin të bashkojë arsimin, kërkimin dhe inovacionin. “Pastaj, nuk arrin të jep përgjigje për çështjen se në çfarë niveli do të sigurojë cilësinë. Për shkak absurditetit me të cilën është ndërtuar rrjeti i arsimit të lartë Maqedoni, aktualisht kemi 24 universitete, me mbi 130 fakultete dhe mbi 600 programe studimore”. Gjithë ky zgjerim, sipas akademik, Fitit ka shkuar në dëm të cilësisë dhe prandaj është shumë e rëndësishme të shihet nëse Propozim-ligji ofron ngritje të konsiderueshëm të cilësisë në arsim, apo jo. Në këtë pikë, ku një rol të konsiderueshëm luan Këshilli për Akreditim, kryetari i AMSHA-së mendon se duhet të planifikohet jo vetëm rritja e kriterëve për zgjedhjen e anëtarëve të këtij këshilli por të mendohet edhe mendon se përfshirja e ekspertëve ndërkombëtarë, të cilët do të ndihmonin me përvojën e tyre. Një

aspekt tjetër me rëndësi që duhet të sigurojë Ligi është edhe orientimi i studentëve dhe profesorëve drejt zhvillimit të mendimit të pavarur dhe kreativ. Në këtë gjendje, sikurse është Propozim-ligji, për arsim të lartë nuk jep asnjë zgjidhje as për problemin tjetër të madh që ka momentalisht Maqedonia dhe ky është hendeku i gjerë mes arsimit dhe tregut të punës në kuptimin e mos harmonizimit të kualifikimeve, dhuntive dhe aftësive të studentëve të diplomuar me nevojat e tregut. Një studim i UNESKOS për shtete e Ballkanit Perëndimor, sa i përket Maqedonisë tregon se është shumë i ulët sistemi i efikasitetit në arsimin e lartë viza-vijë biznesit. Ky indeks për Maqedonisë është 13, që do të thotë nga 1000 të diplomuar vetëm 13 mund të gjejnë pa problem punë në bazë të kualifikimeve që kanë.

Vërejtje kanë edhe drejtuesit e universiteteve shtetërore të Shkupit dhe Manastirit. Rektori i Universitetit “Kirili dhe Metodi” në Shkup, Nikolla Jankullovski, vërejtje se nëse nuk ndryshojnë nenet që rregullojnë organizmin e organeve të universitetit, do të vijmë në situata kur Senati do të mund të bllokohet në çdo moment punën e rektorëve. Sepse, sipas tij me Propozim-ligjin e ri rektori vetëm do të ketë përgjegjësi për vendimet që sillen, programet studimore të cilat organizohen mirëpo rrjedha e të gjithë atyre çështjeve do të varren nga kryetari i Senatit. Nëse ky i fundit nuk është dakord me programin e punës së rektorit, nuk do ta vendosën në rend dite një çështje të caktuar e cila është në interes të realizimit të atij programit për të cilën është zgjedhur rektori. Por për Lubomir Gajdov, nga Shoqata e Filozofëve të Maqedonisë, i cili ka gjithashtu shumë vërejtje pajtohet me Propozim-ligjin vetëm në këtë pikë. “Me këtë do të fillon edhe desulltanizimi i rektorëve, u shpreh ai. Ndërkaq, për rektorin e Universitetit “Klimenti i Ohrit” në Manastir, Sasho Korunovskin para se të bëhet Rangimi nacional i universiteteve nga agjenci dhe qendra të huaja që merren me këtë punë, duhet që shteti ti caktojë qartë se kush janë objektivat e rangimit. Rektoret e universiteteve të Tetovës dhe Shtipit munguan në debat.



TAKI FITI

**Propozim-ligji që ka nxjerrë për debat Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH) nuk përmbush as komponentin minimale, pra nuk arrin të bashkojë arsimin, kërkimin dhe inovacionin. Pastaj, nuk arrin të jep përgjigje për çështjen se në çfarë niveli do të sigurojë cilësinë. Për shkak absurditetit me të cilën është ndërtuar rrjeti i arsimit të lartë Maqedoni, aktualisht kemi 24 universitete, me mbi 130 fakultete dhe mbi 600 programe studimore**

shtje të caktuar e cila është në interes të realizimit të atij programit për të cilën është zgjedhur rektori. Por për Lubomir Gajdov, nga Shoqata e Filozofëve të Maqedonisë, i cili ka gjithashtu shumë vërejtje pajtohet me Propozim-ligjin vetëm në këtë pikë. “Me këtë do të fillon edhe desulltanizimi i rektorëve, u shpreh ai. Ndërkaq, për rektorin e Universitetit “Klimenti i Ohrit” në Manastir, Sasho Korunovskin para se të bëhet Rangimi nacional i universiteteve nga agjenci dhe qendra të huaja që merren me këtë punë, duhet që shteti ti caktojë qartë se kush janë objektivat e rangimit. Rektoret e universiteteve të Tetovës dhe Shtipit munguan në debat.

## Në fundjavë shi dhe dëborë

Shkup, 18 janar - Drejtorja e Punëve Hidrometeorologjike gjatë fundjavës paralajmëron reshje të reja të shiut, ndërsa në zonat malore reshje të dëborës. Reshjet e shiut do të fillojnë të shtunën pasdite, ndërsa reshje më të dendura do të ketë të dielën veçanërisht në pjesët veriore dhe perëndimore të shtetit. Nga fundi i ditës reshjet do të kalojnë në lindje dhe do të kalojnë në dëborë në vendet më të larta. Do të fryjë erë e përforcuar veriore. Reshjet do të ndërpriten të hënën në mëngjes, por gjatë ditës do të jetë ftohtë dhe me erë. Sot (e premte) pritet mot i thatë me temperatura e ulëta të mëngjesit të cilat do të lëvizin nga -8 deri në -1 gradë. Gjatë ditës kohë pas kohe do të fryjë erë mesatare jugore.

## Sot ndryshon regjimi i trafikut për Ujin e bekuar

Shkup, 18 janar - Regjim i veçantë i trafikut në disa rrugë në qendër të Shkupit, si dhe në komunat Gjorçe Petrov dhe Aerodrom, do të vendoset sot për shkak të festës fetare Uji i bekuar. Prej orës 10:00 deri në përfundim të manifestimit për Ujin e bekuar në qendër të Shkupit për trafik do të mbyllet rrugët “Filip Vtori” deri te bulevardi “Goce Dellçev” dhe rr. “Kej 13 Nëntori” deri te bulevardi “Koço Racin”. “Në komunën Gjorçe Petrov nga ora 10:00 për trafik do të mbyllet rrugët nga kisha “Shën Pjetri dhe Pali” në të djathtë të bulevardit “Partizanski odredi”, në të djathtë të rrugës “Gjorçe Petrov”, në të majtë të rr. “Vasill Çakallarov”. Si dhe nga kisha “Shën Pantelejmoni” përmes rrugës “Demir Traiko” dhe në të majtë të rrugës “Vasill Çakallarov” deri te Ura e hekurudhave në lumin Vardar, njoftoi SPB Shkup. Ndryshe, 150 njerëz sot pritet të marrin pjesë në hedhjen e kryqit me rastin e Festës Uji i Bekuar në lumin Vardar në qendër të Shkupit, informoi Dioqeza e Shkupit. Paraqitja ishte prej 10 deri 17 janar. Hedhjen e kryqit në ujërat e Vardarit do të jetë sot pasdite nga ura te hoteli “Holidej in” dhe do ta bëjë kreu i Kishës Ortodokse të Maqedonisë z.z. Stefan. Paraprakisht, në orën 9, kryepeshkopi z.z. Stefan do të mbajë meshë në kishën “Shën Mëria”.

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 18 janar - Debati për Propozim-ligjin e Arsimit të lartë nuk ka lënë mënjanë as Akademinë Maqedonase të Shkencave dhe Arteve, e cila i ka kushtuar vëmendjen e veçantë këtij momenti, që sipas shumicës së akademikëve - nuk ka rrjedhën që do të duhej të kishte. “Në fillim duhej të diskutim për reforma në arsimin e lartë, duhej të përpilohej një Strategji, të hartohej Plani operacional për zbatimin asaj reforme dhe pastaj të nxirrej Ligji për arsim të lartë” vëren udhëheqësi i Qendrës për hulumtime strategjike, akademik Vllado Kambovski. Maqedonia, sikurse pohon ai, është vendi i vetëm i rajonit që nuk ka ende një Strategji për arsim të lartë, ndërkaq, për një reformë të mirëfilltë në këtë sferë është e nevojshme që paralelisht Ligjit për arsim të lartë të përpilohet dhe Ligji për kërkime shkencore dhe Ligji për inovacione.

Ligji i ri, të cilin e propozon MASH nuk ofron asnjë ndryshim rrënjësor. Madje një pjesë e madhe e pjesëmarrësve në debatin që organizoi AMSHA-ja thonë ka cemin të standardeve dhe kriterëve për zgjedhjen e profesorëve, anëtarëve

Revizioni ka konstatuar se ka lëshime të mëdha lidhur me të ardhurat e realizuara në raport me ato të planifikuara. Gjithashtu, pjesëmarrja e obligimeve të papaguara ndaj furnizuesve në periudhën 31 dhjetor 2012 deri 31 dhjetor 2016, në raport me të ardhurat e realizuar në nivel vjetor - lëviz prej 25 deri 44 për qind

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 18 janar - Borxhet e komunave për energji elektrike, punë të kryera ndërtimore apo shërbime të tjera, vlerësohen të jenë afër 120 milionë euro. Vetëm deri në fund të vitit 2016 borxhet kanë arritur në 82 milionë euro. Por borxhi i komunave mund të jetë edhe më i madh, duke tejkaluar shifrën prej 120 milionë euro, nëse shtohen edhe obligimet në bazë të vendimeve gjyqësore dhe të kamatave.

Sipas analizës së revizorëve, ekziston mosharmonizim i madh midis evidencës së komunave dhe numrave të Ministrisë së Financave lidhur me borxhet që i kanë komunat në bazë të vendimeve ekzekutive gjyqësore. Nga të dhënat e dikasterit të financës, merret vesh se obligimet në bazë të vendimeve gjyqësore, arrijnë 37.4 milionë euro, ndërsa evidenca e komunave tregon se obligimet janë afër 5.8 milionë euro. Sipas raportit të fundit të revizorit "Obligimet dhe jostabiliteti financiar i komunave" për periudhën 2012-2016, vetëqeverisjet lokale jo vetëm që kanë borxh të madh ndaj kompanive private dhe shtetërore, por ato edhe kanë rritur borxhin për 27 milion euro nga 55 milionë euro në vitin 2012 në 82 milionë euro në vitin 2016.

## ANALIZË E REVIZORIT TË MAQEDONISË

# KOMUNAT, 120 MILIONË EURO BORXHE

## PLANIFIKIM JOREAL I BUXHETEVE

Raporti kushtuar llogarive të bllokuara komunale thekson më tej se obligimet e përgjithshme ndaj furnizuesve përfshijnë 35 për qind e të ardhurave të përgjithshme që i realizojnë komunat, ndërsa disa komuna kanë grumbulluar obligime të pashlyera që arrijnë deri 80 për qind e të ardhurave që i realizojnë në buxhet. Revizorët kanë konstatuar edhe më shumë probleme të tjera të komunave lidhur me financimin e tyre.

"Komunat karakterizohen me planifikim joreal të buxheteve, ose revizioni ka konstatuar se ka lëshime të mëdha lidhur me të ardhurat e realizuara në raport me ato të planifikuara. Gjithashtu pjesëmarrja e obligimeve të papaguara ndaj furnizuesve në periudhën 31 dhjetor 2012 deri 31 dhjetor 2016, në raport me të ardhurat e realizuar në nivel vjetor lëviz prej 25 deri 44 për qind", theksohet më tej në raport.

Gjithashtu analizat tregojnë se një pesta e komunave apo 20 për qind nga 80 komuna në Maqedoni janë me llogari të bllokua-

ra si rrjedhojë e vendimeve ekzekutive gjyqësore në bazë obligimeve të pashlyera ndaj furnizuesve dhe të punësuarve. Si obligimet më të shpeshta për të cilat kanë hyrë komunat në borxh janë ato ndaj firmave ndërtimore dhe kompanive të tjera, obligimet për energjinë e papaguar e papaguar, si dhe obligimet e trashëguara në bazë të ekspropriimit të pronës. Në ndërkohë, borxhi vetëm i komunave me llogari të bllokuara deri në muajin maj të vitit 2017 ka arritur 40 milionë euro. Raporti i revizorit më tej thekson se përkundër faktit se komunat nuk kanë të holla për pagesën e borxheve të vjetra, ato kanë vazhduar të hyjnë edhe më tej në borxhe të reja.

"Në kushte të jostabilitetit financiar të komunave, kemi konstatuar se të njëjtat kryejnë procedura për punësime të reja dhe avancimin e të punësuarve aktual, si dhe furnizime publike. Nga 14 komuna me llogari të bllokuara, ose jostabilitet financiar në vitin 2016, tek 9 prej tyre kanë filluar investime kapitale, punësime të reja dhe avancimin e të punësuarve", thekson raporti.

## KOMPETENCA PO, POR JO EDHE FINANCA

Revizorët shtetëror rekomandojnë që kryetarët e komunave në një situatë të tillë kur kanë llogarinë e bllokuar, ose kanë jostabilitet financiar, të veprojnë në bazë të neneve 39 deri 43 të Ligjit për financimin e komunave, ose të shpallin vendim për jostabilitet financiar dhe të ndërmarrin aktivitete për zgjidhjen e këtij problemi. Gjithashtu, revizorët theksojnë nevojën që Ministria e Financave të kryejë mbikëqyrjen e realizimit të Ligjit për financimin e Njësisë të Vetëqeverisjes Lokale dhe të ndërmarrë masat e përcaktuara ligjore për moszbatimin në rast të gjendjes së jostabilitetit financiar në komuna. Revizorët u bëjnë thirrje edhe kryetarëve të gjykatave që të shqyrtojnë vendimet e miratuara për shumën e të hollave të nevojshme për kryerjen e veprimtarisë, duke përjashtuar ato nga realizimi me qëllim që të mundësojnë pagesat e vendimeve të arritura për pagesë si dhe të mundësojnë që borxhet të fillojnë të paguhen dhe të zvogëlohen.

Ekonomistët thonë se shteti shpesh toleron edhe mos-pagesën

e borxheve të ndryshme nga ana e komunave për shkak të fuqisë së tyre të dobët financiare dhe shumës së ulët të tatimeve që ju transferohet nga buxheti qendror tek buxheti lokal. Komunat në një pjesë të madhe kanë fituar kompetenca të ndryshme, por jo edhe të holla nga lartë për të realizuar obligimet e ndryshme që i kanë ndaj banorëve të komunave si urbane ashtu edhe rurale.

Në praktikë, një numër i caktuar i komunave kanë vendim nga gjykata përkatëse për kufirin, ose për shumën e të hollave që ju nevojiten në mënyrë të domosdoshme për kryerjen e veprimtarive të ndryshme të komunës. Kjo nënkupton se mjaft biznese edhe pse kanë vendime gjyqësore për pagesën e borxheve të ndryshme, nuk mund ti paguajnë të njëjtat për shkak të tavanit të borxhit ose kufirit të përcaktuar me ligj. Kjo do të thotë se bizneset mund ti paguajnë borxhet, por paguajnë vetëm mbi shumën e përcaktuar me ligj, që nënkupton se përkundër vendimeve gjyqësore në të vërtetë kufiri ligjor i pamundëson ti paguajnë borxhet nga komunat.

## Zvogëlohen rezervat afariste, priten punësime të reja

Shkup, 18 janar - Gjendja ekonomike e subjekteve afariste në tremujorin e katërt të vitit 2017 është më e pavoritshme në krahasim me tremujorin paraprak, ndërsa më e volitshme në krahasim me tremujorin e katërt të vitit 2016. Siç kumtoi Enti Shtetëror i Statistikës, pritet që gjendja të jetë edhe më e pavoritshme gjatë tre muajve të ardhshëm. Sipas udhëheqësve të subjekteve afariste, sasia e rezervave u zvogëlua, ndërsa gjendja financiare në tremujorin e katërt të vitit 2017 është më e volitshme në krahasim me tremujorin e tretë të vitit 2017. Vlerësimi për porositë e pritura për periudhën e ardhshme është më i pavoritshëm, ndërsa pritet rritje e numrit të të punësuarve. Ndikim më të madh mbi kufizimin e

gjendjes ekonomike të subjekteve afariste gjatë tremujorit të katërt të vitit 2017 kanë pasur kërkesa e dobët e blerësve me 31.5 për qind, konkurrenca e rritur e tregut me 18.3 për qind, mungesë e kadrove të trajnuar me 12 për qind dhe oferta e rritur në treg me 11.1 për qind. Çmimet shitëse në tremujorin e katërt të vitit 2017 janë rritur në mënyrë të pakonsiderueshme në krahasim me tremujorin e tretë të vitit 2017, ndërsa pritet zvogëlimi i tyre gjatë tre muajve të ardhshme. Indikatorit i besimit në tregtinë me pakicë në tremujorin e katërt të vitit 2017 është rritur për 0.1 për qind në krahasim me tremujorin paraprak, ndërsa është rritur për 1.2 pikë procentuale në krahasim me tremujorin e njëjtë të vitit 2016.

## Qeveria bullgare e miratoi roamingun e ulët me Maqedoninë

Sofje, 18 janar - Qeveria bullgare sot e miratoi Memorandumin mes qeverive të Maqedonisë dhe Bullgarisë për uljen e tarifave ndërkombëtare për roaming në shërbimet e telekomunikacionit, kumtoi shërbimi për shtyp i Qeverisë bullgare. Memorandumin në mbledhjen e përbashkët në Strumicë, më 23 nëntor të vitit të kaluar, e nënshkruan ministri i Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Damjan Mançevski, dhe ministri bullgar i Transportit dhe Teknologjive Informatike, Ivajllo Moskovski. Dokumenti mundëson që trupat rregullator të të dy shteteve të fillojnë procedurë me të cilën do t'i nxisin

operatorët të kyçin kontrata për çmime më të ulëta gjatë bisedës, porositë dhe internetit në roaming. Për momentin, roamingu mes dy vendeve është mes më të shtrenjtëve në Evropë dhe paraqet mes 1,5 dhe 3,5 euro për minutë, përkatësisht rreth 12,5 euro për megabajt (MB). Maqedonia është shteti i parë nga Ballkani Perëndimor me të cilin Bullgaria nënshkroi memorandum për ulje të çmimit të roamingut. Ulja e çmimeve të roamingut me vendet nga Ballkani Perëndimor është mes prioriteteve të kryesimit bullgar me BE-në, kumtoi shërbimi për shtyp i qeverisë bullgare.






DOKUMENTE SHITESË PËR NDIHMËN E FËMIJËS SË TRETË

# VËSHTIRËSOHET MARRJA E SHITESËS PËR FËMIJËN E TRETË

Para disa kohësh, inspektorë të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale kanë kërkuar nga nëpunësit në Qendrën sociale në Tetovë që palëve t'ju kërkohej edhe një dokument që vërteton vendqëndrimin e nënës që përfiton shtesën prindërore tre vite përpara se të aplikojë



ABUSH BAJRAMI

**Ka afat plot, por për një ditë që janë parashtruar 100 kërkesa - qytetarëve ju është thënë pas dy jave të vini ta merrni dokumentin, por kur numri do të arrijë në 3000 kërkesa, atëherë çfarë do të ju thonë. Vetëm një numër i vogël i qytetarëve kanë arritur të sigurojnë këtë dokument. Bëhet fjalë për një numër të vogël - 10 apo 15, nuk jam i sigurt se sa të tjerët presin, kush ka dikë që e njeh në Sektorin për Punë të Brendshme në Tetovë, do të arrijë që për një kohë të shkurtër ta sigurojë, ndërsa kush nuk ka të njohur - do të duhet që të presë dy-tre javë**

deri në fund të muajit të mars, kur është afati i fundit për ripërtëritje të dokumentacionit - do ta humbin këtë të drejtë. Për nëntë vite, në Tetovë që përfitojnë këtë shtesë prindërore për fëmijën e tretë janë diku rreth 3100 qytetarë shfrytëzues të kësaj shtese prindërore prej 8362 denarëve. Në këtë numër bëjnë pjesë edhe ata të cilët marrin shtesë prindërore për fëmijën e katërt që janë gjithsej 72 persona e që marrin 11.700 denarë. Ky numër ka ngelur nga 2009 kur në atë kohë nga shteti ndahente shtesë prindërore edhe për fëmijën e katërt, për t'u ndërprerë pastaj për rastet e reja.

**Javën e kaluar, 428 raste të reja të të sëmurëve nga gripi**

Shkup, 18 janar - Javën e kaluar (nga 8 janari e deri më 14 janar), në Republikën e Maqedonisë janë regjistruar 428 raste të reja të të sëmurëve nga gripi, që është rritje për 74 për qind krahasuar me javën para saj (nga 1 janari e deri më 7 janar) kur ishin regjistruar 246 persona të sëmurë, theksohet në raportin që në faqen e internetit sot e publikoi Instituti i Shëndetit Publik. Nga Instituti theksojnë se në krahasim me sezonin e kaluar kur janë regjistruar 5.475 raste, ekziston ulje e dukshme të numrit të të sëmurëve në javën e dytë, që arrin 92,2 për qind. Numër më i madh i të sëmurëve janë paraqitur në grupmoshën më të madhe prej 15-64, ndërsa incidencë më e madhe është regjistruar tek më të vegjlit - fëmijë të moshës prej 0-4 vjet. Këtë javë numër më i madh i të sëmurëve - 125 janë paraqitur nga rajoni i Njësisë rajonale Gostivar, ndërsa incidencë më e madhe është regjistruar në rajonin e Njësisë rajonale Dibër (108,1/100.000 banorë). Në sezonin 2017/2018 numri i përgjithshëm i rasteve të paraqitura të ngjashme me gripin arrin 1.756. Numri i regjistruar i rasteve është më i vogël për 94 për qind krahasuar me periudhën e njëjtë nga sezoni i kaluar nga sezoni i kaluar (29.318). Këtë sezon numër më i madh i personave të sëmurë - 408 janë regjistruar në Njësinë rajonale Gostivar dhe 269 në Qendrën e Shëndetit Publik Tetovë, ndërsa incidencë më e madhe është regjistruar në Njësinë rajonale Dibër. Gjatë javës së dytë të sivjetme, në laboratorin virologjik të Institutit të Shëndetit Publik janë testuar 16 materiale për grip. Nga materialet e testuara, gjashtë janë pozitive për prezencë të virusit të influencës - dy influenza A (H1N1) pdm dhe katër influenza B.

Koha

Urim HASIPI

Tetovë, 18 janar - Vështirësohet mënyra e aplikimit për prindërit, të cilët kanë fëmijë të tretë. Tash në këtë fillimvit kur edhe ka filluar ripërtëritja e dokumenteve - nëpër Entet për punë sociale në Tetovë situata është alarmante dhe dramatike, sepse prindërve u kërkohen kushte që deri më tani nuk u janë kërkuar gjatë rregullimit të dokumenteve. Para disa kohëve, inspektorë të Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale kanë kërkuar nga nëpunësit në Qendrën sociale në Tetovë që palëve t'ju kërkohej një dokument që vërteton vendqëndrimin e nënës që përfiton shtesën prindërore tre vite përpara se të aplikojë. Këtë e kanë konfirmuar edhe në Qendrën për Punë Sociale në Tetovë. Udhëheqësi i Sektorit për Mbrojtje të Fëmijëve në Qendrën ndërkomunale për Punë Sociale në Tetovë, Abush Bajrami, thotë se është i

detyruar që të zbatojë këtë urdhër. "Jemi të detyruar ta zbatojmë këtë urdhër dhe ta kërkojmë atë dokument që e jep Sektori për Punë të Brendshme në Tetovë. Atje ne i udhëzojmë palët për të shkuar dhe për ta marrë. Para dy ditëve kemi filluar me ripërtëritjen e dokumenteve, ndërsa nga policia personave që ripërtëritjen dokumentet për të përfutur shtesën prindërore për fëmijën e tretë ju kanë thënë që të vijnë pas dy jave për të siguruar dokumentin e nevojshëm. Ne kemi filluar para dy ditëve kurse ato u thonë ejani pas dy jave. Po çfarë do të bëjmë ne kur do të mblidhen dy mijë apo tre mijë kërkesa, nuk do të arrijmë që deri në vitin e ardhshëm të kompletojmë dokumentacionin e nevojshëm për përfitim të shtesës prindërore nga ana e shtetit. Kjo mendoj se ka prapavijë tjetër, afati për kompletimin e dokumentacion - gjegjësisht për ripërtëritjen e këtij dokumentacioni është deri

në fund të marsit", thotë Bajrami. Megjithatë, nga kjo qendër thonë se një numër shumë i vogël ka arritur që të sigurojë këtë dokument. "Ka afat plot, por për një ditë që janë parashtruar 100 kërkesa - qytetarëve ju është thënë pas dy jave të vini ta merrni dokumentin, por kur numri do të arrijë në 3000 kërkesa, atëherë çfarë do të ju thonë. Vetëm një numër i vogël i qytetarëve kanë arritur të sigurojnë këtë dokument. Bëhet fjalë për një numër të vogël - 10 apo 15, nuk jam i sigurt se sa të tjerët presin, kush ka dikë që e njeh në Sektorin për Punë të Brendshme në Tetovë, do të arrijë që për një kohë të shkurtër ta sigurojë, ndërsa kush nuk ka të njohur - do të duhet që të presë dy-tre javë", shprehet Bajrami. Edhe pse kërkuam sqarim nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, megjithatë përgjigje nuk kemi marrë deri më tani. Ata që nuk e sigurojnë këtë dokument

## 90 MILIONË DENARË PËR INFRASTRUKTURËN RRUGORE TË DIBRËS

Dibër, 18 janar - Gjithsej 89.28 milionë denarë planifikon të shpenzojë Komuna e Dibrës sivjet për përmirësim të infrastrukturës rrugore. Mjetet janë projektuar në Programin për ndërtim, rikonstrukcion, mirëmbajtje dhe mbrojtje të rrugëve lokale dhe rrugëve të qytetit. "Pjesa më e madhe, 44 milionë denarë, do të jenë për ndërtim të rrugëve lokale. Prej tyre, 15 milionë janë për ndërtim të rrugës vendkalimi kufitar 'Bllato', fshati Banjishtë, tetë milionë për ndërtim të rrugës lokale e cila i lidh fshatrat Ame dhe Banji-



shtë, ndërsa 4,2 milionë për ndërtim të rrugës deri në fshatin Bomboko", thotë Petrit Paçuku, udhëheqës i sektorit për urba-

nizëm në komunën e Dibrës. Sipas tij, me Programin parashikohet ndërtim i rrugëve lokale në më shumë fshatra, për të cilët janë pa-

raparë mjete në vlerë prej 300.000 deri në 1,2 milionë denarësh. Për ndërtim dhe renovim të rrugëve në qytet janë planifikuar mbi 40 milionë denarë. "Mjetet e planifikuara në krahasim me vitin e kaluar janë më të ulëta për rreth 30 milionë denarë sepse një pjesë e madhe e rrugëve në qytet fituan asfalt të ri, ndërsa pothuajse në të gjithë rrugicat në Dibër dhe fshatrat janë vendosur pllaka", shton Paçuku. Me Programin për mirëmbajtje dimërore të rrugëve komunale dhe rrugëve në qytet dhe në fshatra janë planifikuar dy milionë

denarë. Gjithashtu mjete financiare janë planifikuar për rikonstrukcion të gropave të theksuara nëpër rrugët në qytet dhe fshatrat dhe nga 500.000 denarë për vendosje të sinjalizimit vertikal dhe horizontal dhe për përgatitje të projekteve dhe studimeve. Mjetet planifikohet që të grumbullohen 10 milionë denarë nga Ndërmarrja Publike për Rrugë Shtetërore Shkup, 35 milionë nga participimi (komuna dhe popullata komunale), 24 milionë nga Agjencia për Zhvillim të Barabartë dhe mbi 20 milionë denarë janë donacione.

# Kufiri me Malin e Zi, atribut i Kosovës

Nga  
Dr. Islam Lauka



Tashmë, është bërë plotësisht e qartë që marrëveshja e nënshkruar, me 26 gusht 2015, në Vjenë, midis Kosovës dhe Malit të Zi, "Mbi kufirin shtetëror", ka të bëjë, jo me shënjim, por me përcaktim të kufirit midis dy vendeve. Ashtu siç është plotësisht e qartë që ka një zhvendosje të dukshme nga vija historike e kufirit Çakorr-Kullë, në brendësi të territorit të Kosovës, pa dyshim, në dëm të saj. Megjithatë, nuk janë të paktë ata që kërkojnë ratifikimin e Marrëveshjes së Demarkacionit, në mbledhjen e parë të këtij viti të Kuvendit të Kosovës. Midis tyre, ka edhe nga ata, përfshirë zyrtarë të lartë shtetërorë, deputetë, etj. që e pranojnë hapur se marrëveshja është e gabuar dhe në dëm të interesave themelore të Kosovës, por përsëri këmbëngulin në ratifikimin e saj, për shkak, siç pohojnë ata, të pasojave negative për të sotmen dhe të ardhmen e vendit. Në formë të përmbledhur, "argumentet" e ithtarëve të kësaj teze, janë këto:

1. Ratifikimi i Demarkacionit dhe lufta kundër korrupsionit përbëjnë dy kriteret e fundit, të vendosura nga Bashkimi Europian për liberalizimin e vizave. Ratifikimi hap dyert e Europës për shqiptarët e Kosovës, mosratifikimi i izolon ata, përfundimisht.

2. Marrëveshja "Mbi kufirin shtetëror" me Malin e Zi është nënshkruar nga autoritete të larta zyrtare dhe ratifikimi i saj do të dërgonte sinjale pozitive për Kosovën, si një shtet serioz që u qëndron angazhimeve që marrin përsipër përfaqësuesit e saj të lartë, si dhe atyre ndërkombëtare, ndërsa mosratifikimi do të ulte kredibilitetin dhe imazhin e saj në botë.

3. Ratifikimi kërkohet nga miqtë dhe aleatët tanë strategjikë, SHBA dhe fuqitë kryesore europiane, pa ndihmën e të cilëve do të ishte i pamundur, jo vetëm çlirimi i Kosovës nga sundimi serb, por edhe mbrojtja e lirisë dhe pavarësisë së saj. Mosratifikimi mund të çojë në ftohjen e tyre ndaj nesh, apo më keq, në humbjen e tyre si miq dhe aleatë tanë. Në një zhvillim të tillë negativ, Kosova rrezikon të humbë gjithë arritjet e deritanishme.

4. Mali i Zi është anëtar i NATO-s, ka hapur negociatat për anëtarësim në BE dhe Kosova nuk ka asnjë interes t'i përkeqësojë marrëdhëniet me të, aq më tepër

që e kemi vend fqinj.

Më shumë se "argumente", këto janë hamendësime, frikëra e shqetësime për rreziqe potenciale që mund t'i kanosen Kosovës, në rast të mosratifikimit të Marrëveshjes së Demarkacionit. Ballafaqimi i këtyre "argumenteve" me faktet historike, me përvojën dhe praktikën e shteteve të tjera (precedentët e ngjashëm), me logjikën e thjeshtë, si dhe ligjin ndërkombëtar, i bën ato krejtësisht të paqëndrueshme. Për pasojë, edhe frikërat dhe shqetësimet që i shoqërojnë ato, janë pa bazë. Së pari, Kosovës i është dhënë Harta e Rrugës për liberalizimin e vizave në Qershor 2012, pra para 6 vjetëve dhe në atë hartë nuk ka figuruar fare kriteri i ratifikimit të Demarkacionit me Malin e Zi.

Ai është shtuar rrugës, tash vonë, arbitrarisht, pa u konsultuar fare me aktorët vendorë dhe, mundet, as me institucionet europiane. Kriteri i shpikur i ratifikimit të Demarkacionit, nuk përjashtohet të jetë pjellë e fantazisë së sëmure të ndonjë euroburokрати apo eurokomisari që nuk e njeh fare Kosovën dhe as ndjeshmëritë e saj historike, apo edhe të kohëve moderne. Është fakt i njohur që një kriter i tillë nuk

i është vënë asnjë prej shteteve të dala nga ish-Jugosllavia. Logjika do ta donte që, nëse i duhej vënë dikujt një kriter i kësaj natyre, atëherë ky dikushi do të duhej të ishte Serbia, e cila mban autorësinë e 4 luftrave agresive në Ballkan. Por jo, euroburokratët e gjetën të udhës që t'i imponojnë atë viktimit të dhunës shtetërore serbe – Kosovës. Jo vetëm kaq, kriteret që i janë imponuar Kosovës për liberalizimin e vizave janë rreth dyfishi i atyre të Serbisë. Ku është e drejta këtu? Ku janë vlerat, me të cilat euroburokratët e kanë gojën të mbushur plot?

Edhe kriteri tjetër, ai i luftës kundër korrupsionit, në mënyrën se si është formuluar, duket se është më shumë një mjet për t'u mbyllur gojën udhëheqësve politikë dhe popullit të Kosovës, në rast se këmbëngulin për liberalizimin e vizave. Sepse, me këtë kriter, përgjigja e Brukselit është e gatshme: keni ende shumë për të bërë në luftën kundër korrupsionit! Po kush e vendos se ky kriter është plotësuar dhe mbi çfarë baze? Si e mat Brukseli realizimin e këtij kriteri? Apo kjo çështje mbetet në kompetencën, në fakt, në arbitrari-

**Kriteri i shpikur i ratifikimit të Demarkacionit, nuk përjashtohet të jetë pjellë e fantazisë së sëmure të ndonjë euroburokрати apo eurokomisari që nuk e njeh fare Kosovën dhe as ndjeshmëritë e saj historike, apo edhe të kohëve moderne. Është fakt i njohur që një kriter i tillë nuk i është vënë asnjë prej shteteve të dala nga ish-Jugosllavia**



tetin e euroburokratëve?

E vetmja e dhënë konkrete në këtë fushë vjen nga organizata, Transparency International, e cila, çdo vit, boton renditjen e vendeve, në shkallë botërore, lidhur me perceptimin e korrupsionit. Në botimin e saj të fundit (2016), Kosova figuron në vendin e 95-të (nga 177 vende, të marra në shqyrtim), Moldavia e 123-ta, ndërsa Ukraina e 131-ta. Këto dy të fundit, në vitin 2016, fituan liberalizimin e vizave, kurse Kosova që është në pozita shumë më të mira se ato, jo. Edhe po të krahasohet me vendet e Ballkanit Perëndimor, qytetarët e të cilëve ka vite që lëvizin lirish në Europë, Kosova nuk është larg tyre: Maqedonia është e 90-ta, Shqipëria është e 83-ta dhe Bosnje-Hercegovina, gjithashtu, e 83-ta. Duhet kuptuar, tashmë, që liberalizimi i vizave për qytetarët e Kosovës varet, jo nga plotësimi i kushteve të sajura të BE-së, por nga vullneti politik i Brukselit, i cili ka kohë që mungon dhe dëshmi e këtij fakti është shtimi dhe imponimi ndaj Kosovës i kriterëve pa kriter, siç është ratifikimi i Demarkacionit me Malin e Zi, apo ai i luftës kundër korrupsionit, krejtësisht i papërcaktuar dhe fluid.

## KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goce Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovrasja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribucioni: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e enjte 18 janar | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006  
Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA  
E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221  
Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Nga sa u tha rreth kësaj pike, mund të arrihet në përfundimin që, në mungesë të vullnetit politik të BE-së, ratifikimi i Demarkacionit, vërshtirë se do t'i hapë dyert e Europës për qytetarët e Kosovës, ashtu si mosratifikimi nuk do t'i izolojë ata përfundimisht.

Së dyti, është e vërtetë që "Marrëveshja për Kufirin" me Malin e Zi është nënshkruar nga Zëvendëskryeministri dhe Ministër i Jashtëm i Kosovës, por në histori ka patur dokumente që kanë mbajtur firma më të rënda, megjithatë, janë hedhur poshtë nga parlamentet. I tillë është rasti i Presidentit Eilson, i cili nënshkroi Traktatin e Versajës dhe Statutin e Lidhjes së Kombeve, të cilat Senati amerikan i hodhi poshtë. Një shembull tjetër, më afër Kosovës: në vitin 2009 zyrtarë të lartë të Shqipërisë dhe Greqisë nënshkruan Marrëveshjen Detare, midis dy vendeve. Ashtu si sot për Demarkacionin, politikanët dhe firmëtarët e Marrëveshjes Detare betoheshin se Shqipëria nuk humb asnjë milimetër nga deti Jon. Por Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë vërtetoi të kundërtën dhe e shfuqizoi atë. Natyrisht, Greqisë nuk i erdhi mirë dhe, si vend më i madh, anëtare e Bashkimit Europian dhe NATO-s, në fillim, u përpoq të ushtronte presion që ta detyrojë Kuvendin e Shqipërisë të ratifikojë marrëveshjen e nënshkruar, por me kalimin e kohës, erdhi duke u qetësuar dhe këto ditë, Athina zyrtare njoftoi se është dakord për fillimin e rinegociimit të saj.

## Të mos heshtim për anomalitë e arsimit tonë



Nga  
Shaban JASHARI

Teksa po shikoja emisionin "klic" në tv21, në studio, gazetari kishte të ftuar Talat Xhaferin, kryetar i Parlamentit të Maqedonisë dhe një grup maturantësh të cilit po bashkëbisedonin në këtë panel mbi arsimin shqip në Maqedoni.

Po shkëpus këtu njërin nga pyetjet që, njëri nga të rinjtë ia parashtrou kryeparlamentarit:

- I nderuari zoti Xhaferi, duke qenë se jam maturant, preokupimet e mia e tonat janë përzgjedhja e universitetit në të cilin do të studiojmë në të ardhmen. Sigurisht se ne e duam ndonjë universitet më të mirë, ndërsa Universiteti i Tetovës na ngelet vetëm alternativë nëse nuk gjejmë vend gjetiu për këtë. Kjo nga se, Universiteti ynë i fituar me aq mund gjak e sakrificë, nuk po na ofron standarde cilësia në nxënie të diturisë. Arsyet i dini z. kryeparlamentar; politizimi i tejskajshëm i universitetit, mungesa e kuadrove adekuate si dhe shumë anomali që arsimi nuk do të duhej t'i toleronte në asnjë mënyrë. Tani më që na u zyrtarizua gjuha shqipe, si një e arritur të cilën e kemi ëndërruar me gjenerata, jemi të detyruar t'i favorizojmë

studimet në gjuhë të huaja për shkak të gjendjes së arsimit shqip tek ne. A nuk u duket kjo tragjike, z. Xhaferi, që ne, edhe më tutje detyrohemi të mësojmë në gjuhë të huaja (maqedonisht) për shkak të politikës?

Pa hyrë në detaje të diskutimeve në këtë emision, doja të them se, më ka prekur pa masë shqetësimi i këtij të riu, i cili, në fakt nuk tha asgjë të re, pos që përshkroi defektet e arsimit shqip në Maqedoni dhe atë, e gjithë kjo me vetë fajin tonë. Dikur ëndërr kishim të studiojmë në gjuhë amtare, tani lutemi të pranohemi në universitete ku mësimi zhvillohet në maqedonisht. Dhe si mos të ishte ndryshe, kur në universitete në gjuhën shqipe në Maqedoni, kuadri mësimdhënës favorizohet nga politika, madje nga aty delegohen funksionarë në organet qendrore; profesori universitar caktohet ministër dhe atë në ndonjë dikaster që s'ka lidhje me lëndën që ai e zhvillon, profesori braktisë mësimdhënien vetëm për këso karriqe të pavlera, kandidon për ambasador, deputet etj. Kështu, ky lloj akademikësh bëjnë xhiro 4-5 vjeçare e më shumë nëpër funk-

**Dikur ëndërr kishim të studiojmë në gjuhë amtare, tani lutemi të pranohemi në universitete ku mësimi zhvillohet në maqedonisht. Dhe si mos të ishte ndryshe, kur në universitete në gjuhën shqipe në Maqedoni, kuadri mësimdhënës favorizohet nga politika, madje nga aty delegohen funksionarë në organet qendrore**




sione, dhe kur u mbaron mandati i kthehen mësimdhënies në fakultete. Shtrohet pyetja, si mund të pritë sukses nga një profesor i cili deri dje ishte ministër i pa kurrfarë suksesi, ambasador pa asnjë rezultat të shënuar, deputet i heshtur e kështu me radhe (çdo respekt përjashtimeve).

I njoh për së afërmi shumë nga këta, ua di edhe emrat bile. të tillët po i shijojmë gjithandë nëpërmjet ish studentëve të tyre nëpër institucione, shumica e të cilëve nuk posedojnë njohuri elementare, e lëre më kapacitete akademike. Këta, në një shoqëri shumëetnike, siç është vendi ynë, shndërrohen në konkurrencë joluajale të atyre që posedojnë diploma të njëmendëshme. Për pasojë, si në shumë segmente tjera, ashtu edhe në arsim, kemi shume probleme të akumuluar me vite, dhe se kjo situatë kërkon zgjidhje sa ma parë.

T'ia nisim nga arsimi, sepse jemi ba turp i dunjas; vetëm ne kemi doktora shkencash që nuk i dinë as përemrat e gjuhës amtare, që nuk e dinë se sa kontinente ka planeti, që nuk njohin asnjë gjuhë të huaj, i kemi, i kemi gjithandë dhe heshtim.

## Shtënia me armë - homo duplex apo fenomen etnopsikologjik



Nga  
Elizabetë QARRI

Megjithëse trashëgimia e një populli konsiderohet si tërësi unike kulturore, individit trashëgon specifika vendore regjionale të cilat në rrethana të caktuara dhe i motivuar nga stimuj të ndryshëm, shpërfaq ato si fenomene të cilat reflektojnë përkatësi kulturore gjeografike, por jo rrallëherë edhe inercion momental arkaik. Harta dhe konteksti gjeografik duke pasur parasysh jetën sociale si faktor kulturor, janë determinantë kryesorë të përcaktimit të sjelljeve njerëzore në shoqëri, e rrjedhimisht edhe fenomeneve të ndryshme që shfaqen në një kontekst të caktuar shoqëror.

Disa procese që lidhen me historinë e një populli apo edhe me vetë jetën e individit si qenie, ashtu sikur kanë kohën kanë edhe momentin e tyre. E tillë ishte edhe shtënia me armë, e cila në të kaluarën tonë kishte qëllim dhe funksion konkret, pra kushtrimin

përkatësisht lajmërimin e krushqve kur "merrnin nusen" apo manifestimin e ceremonialeve e gëzimeve të ndryshme familjare.

Por, bartja e këtyre fenomeneve nga një hapësirë autentike burimore para një populli nga përmbajtja heterogjen, në rrethanat e sotme ka një transpozicion të madh si emocional ashtu edhe psikologjik dhe si e tillë shkakton gjendje objektivisht të papranueshme. Një popull i qytetëruar ruan dhe çmon kulturën e tij autentike, por keqinterpretimi dhe keqpërdorimi i karakteristikave apo ritualeve të caktuara në emër të "tradicionales" qoftë me apo pa vetëdije, cenon vlerat e secilit popull, komb apo edhe vetë individit. Në qoftëse problemit i qasemi nga pikëpamja socio-kulturore, bartja e "ritualit" të shtënies me armë nga origjina e tij autentike paraqet një problem tejet kompleks për shoqërinë tonë, e mbi të gjitha shpërfaq një mentalitet të ashtuquajtur "folklorizëm" i cili qoftë edhe nga ky

këndvështrim i trajtuar, dëmton sërish trashëgiminë shpirtërore të popullit. Tiparë kundërthënës neve shqiptarëve na kanë karakterizuar historikisht, si psh. temperamentin në njërin anë dhe durimin në anën tjetër, por jo rrallëherë këto karakteristika janë përcjellur edhe me nevojën e pamposhtur për tu identifikuar me "tiparë burrororë".

Deliri i manifestimit të gëzimit bashkë me dramën e rrezikut për jetën brenda një uniteti binar, sintetizon egon njerëzore dhe logjikën e stoicizmit, e këto bashkë shpeshherë për bilans kanë sjellë fatalitetin njerëzor, fenomen ky që na ndjek edhe sot, e fatkeqësisht, akoma nuk po ia dalim të mohojmë akte të tilla. Duhet të kuptojmë se me ndryshimin e kushteve dhe rrethanave të jetës, natyrisht ndodhin edhe transformimet në shoqëri. Si pranimin, ashtu edhe refuzimin e fenomeneve të caktuara në shoqëri, duhet trajtuar si probleme socio-kulturore,

që lëndojnë integritetin njerëzor por dhe të pengojnë emancipimin e tyre. Duke qenë shoqëri në zhvillim, duhet të kuptojmë se krahas saj evoluojnë edhe proceset shoqërore në përgjithësi, pra evoluimi ecë paralelisht me të gjitha transformimet që ndodhin brenda saj në të gjitha sferat e jetës, e këto etapa duhet akceptuar si normale. Përveç tjerash, evoluimi nënkupton edhe transformimin e nivelit të traditës nga një periudhë kohore në një tjetër. Duke e ndjekur këtë transformim në shoqëri, njeriu modern i nënshtrohet një dinamike të caktuar shoqërore, duke respektuar një rend sistematik, i cili apriori nënkupton respektim të normave të asaj shoqërie. Pra, çdo tendencë për të justifikuar apo relativizuar aktin e fenomeneve të tilla qoftë edhe aktin e shtënies me armë gjithnjë në emër të "tradicionales", paraqet elementë të theksuar të problematikave etnopsikologjike.

Në anën tjetër, paraqitet fenomeni homo duplex dhe individit i ndrydhur në mes veprimeve e dëshirave të nxitura nga instikti, si dhe kufizimeve shoqërore si ndërgjegje kolektive, e cila në njëfarë mënyre disiplinon dëshirat e vullnetit individual. Në këtë antagonizëm, gjejmë rivalitet midis integritetit apo jo të individit brenda normave shoqërore. Në shoqëritë e bazuara në lidhje farefisnore ndërgjegjja kolektive është më e ulët, që do të thotë se sa më i pa integruar të jetë komuniteti, aq më "normal" cilësohet fenomeni. Duke qenë homogjene për nga struktura, në këto rrethana është mjaft i theksuar solidariteti, i cili poashtu është nxitës i madh i këtyre dukurive. Në të kundërtën, një shoqëri e integruar dhe me ndërgjegje të lartë, marrëdhëniet shoqërore i vendos në funksion të artit dhe shkencës ndërkaq perspektivën e saj e ndërton drejt normave universale, si parime të vetme të një mjedisi modern.

## VITI I SKËNDERBEUT



Sipas arkivës së familjes që ruhet në rezidencën e tyre të Rufanos, ajo në historinë e saj ka pasur një kryetar bashkie të Leçes, poeteshën e njohur Izabela (Isabella), e cila zë vend edhe në Enciklopedinë italiane të Njerëzve të Shquar. Kanë pasur edhe avokatin Federino, i cili në gjyqin politik kundër republikanëve garibaldinë të famshëm si Luixhi Setembrini, Filipo Agresti dhe Silvio Spaventa, u bëri një mbrojtje të zjarrtë

# POETJA ITALIANE IZABELA, PASARDHËSJA E SKËNDERBEUT

Nga Ylli POLOVINA

Poeteshës Izabela Kastrioti (Scanderbeg) nuk i çel vend me përfillje të dukshme vetëm Enciklopedia italiane e Njerëzve të Shquar. Emri i saj, me një vëllim jo të vogël shpjegues, gjendet edhe në fjalorin enciklopedik të famshëm italian, Treccani. Aty shkruhet se "CASTRIOTA SCANDERBEG, Isabella" shënon se ka lindur në Leçe, më 1 shtator 1704 prej prindërve Alessandro dhe Irene Pieve-Sauli Në degën kastriotase të Leçes në Itali lindi më në fund Gjergji më i ri. Alesandro edhe Paola e Xhulio, qenë krijesa të dashura të babait të tyre, Gjergjit të Katërt të degës Kastriotase të Leçes, i cili pati lindur në 1931 dhe ndërroi jetë në 1996. Ky Xhorxho qe martuar me Maria Tereza Bandelon (Maria Teresa Banello), të cilën kam pasur rastin ta takoj jo vetëm një herë, në rezidencën-kështjellë të Kastriotëve të Leçes, në Rufano, Leçe.

Paola është fëmija e tyre më e madhe, sot 57-vjeçare, avokate. I dyti është Alesandro (aktualisht në moshën e 56 viteve). I fundit i fëmijëve të Gjergjit të Katërt dhe i Maria Terezës, Xhulio, ka mbushur 51 vite jetë. Sipas këtij rendi në linjën e së drejtës si trashëgimtar i linjës mashkullore të degës kastriotase natyrore të Leçes është Alesandro. Mirëpo dy fëmijët e parë të tij qenë dy vajza (Xhulia dhe Izabela), shumë të mprehta si i ati dhe mjaft të ëmbla e të urta, si nëna e tyre, belgia Karolina Tulkens (Caroline Tulkens).

## MUNDËSIA E TË PASURIT NJË DJALË DUKEJ E VËSHITRË

Për fat, djalin e lindi i vëllai i vogël, gjyqtari shumë i njohur italian, Xhulio, dhe me këtë rast në degën e tyre u sigurua vijimi. Të mos harrojmë se tre degë të tjera të dinastisë së Kastriotëve në Itali, që rridhnin, siç kemi shpjeguar në shkrimin e djeshëm, prej djemve jashtëmartesorë të nipit të Skënderbeut, dukës Ferrante, janë shuar pikërisht për shkak të moslindjes së meshkujve. Por, për fat, dy degët e mbijetuara për afro një gjysmëshekull, ajo e Leçes dhe e Napolit bëjnë vazhdimisht djem, cilësi që e kishte edhe i ati i Gjergjit në Shqipëri, Gjoni, me katër të tillë. Pasi Skënderbeu me të parin fëmijë të lindur menjëherë mashkull (Gjonin). Ky i fundit kishte katër djem dhe një vajzë (Gjergji, Kostandino, Federiku, Ferrante dhe Maria). Trashëgimtari vijues, duka Ferrante, e vazhdoi traditën me një vajzë brenda martesore (Erina) dhe pesë djem jashtëmartesorë (Federiku, Alfonsi, Pardo, Akili dhe Çezari).

Kjo epërsi e dukshme e lindshmërisë mashkullore te Kastriotët, me sa duket, u riprovua edhe tek Alesandro. Në lindjen e tretë të Karolinës, më 7 shtator 2013, dhjetë mote më i vogël se motra e tij Izabela dhe njëmbëdhjetë prej Xhulias, doli në jetë djali i tyre, Gjergji i Pestë i pemës gjenealogjike, dega e Leçes. Quket Giorgio Vitantonio Erik. Sigurisht është një Castriota. Ky Gjergj vetëm trevjeçar, më i vogli i pasardhësve realë të Skënderbeut në Itali, duket si

i lindur për të qenë një njeri jo i luftës, por i dialogut dhe i paqes

## KURORË INTELEKTUALËSH

Siç e rrëfyem në shkrimin e ditës së djeshme, ndërsa pasardhësit natyrorë të Heroit tonë Kombëtar të degës së Napolit rridhnin prej djalit jashtëmartesor të nipit të Skënderbeut, dukës Ferrante, Akilit, ata të degës së Leçes kanë themelues të tyre vëllanë tjetër, edhe ai jashtëmartesor, Pardon. Ky ka lindur në 1538 dhe vdekjen e pati në vitin 1574. Pardo ka qenë martuar me Antonella Stefanjolin. Pas tij në pemën gjenealogjike të familjes vazhdon Fabio Konstandino (Fabio Costandino), 1574-1615, i cili pati lidhur jetë bashkëshortore me Antonia Verdeska. Pasardhësi tjetër, Costandino, i thirrur më pas Alessandro (1616-1643) qe martuar me Donada Kurki (Donada Curchi).

Shkon më tej dega kastriotase e Leçes me Vitantonio (1641-1716), vënë kurorë ky me Isabella Castriota Scanderbeg i Morixhinos (Morigino). Këtu shfaqet rasti i parë i një martese të pasardhësve të Skënderbeut brenda për brenda fisit. Në pemën gjenealogjike pason Alessandro (1659-1743), i martuar tri herë, dy prej tyre janë bija në familje markezësh.

Brezi i mëpasshëm ka trashëgimtar të parë të emrit të shquar të familjes Vitantonio (1717-1811). Ky qe klerik. Ishte martuar me Donikën (Donica Kastriota Skanderbeg) të baronëve të Galianos. Kjo është hera e dytë në degën e Leçes kur dy të njëjtit gjak krijojnë familje dhe pasardhës të të njëjtit stërgjysh të famshëm. Vijon Alessandro (1748-1803), guvernator, me jetë të lidhur përgjithmonë me Anxhola (Angiola) Lentini, në qytetin dhe rrethinat e Manopolit, grua me titull fisnik.

Më pas, në pemën gjenealogjike, ia behu Gjergji (Giorgio) (1796-1846), gjykatës i Gjykatës së Lartë Kriminale. Qe martuar me Karlotën (Carlota Lopez y Royo), e dukëve në Taurisano. Pastaj erdhi një Alessandro tjetër (1834-1875), me bashkëshorte Marie (Maria Mariglia). Giorgio i viteve 1871-1906 qe pasardhësi i radhës i degës kastriotase të Leçes, i martuar me Françeskën (Franceska Bottari) nga baronët e Paretaltos. Gjenerata pasuese e Kastriotëve të Leçes vijoi me një Alessandro të gjashtë (1898-1959). Ky pati shoqe jete Ida Pio.

Sipas arkivës së familjes që ruhet në rezidencën e tyre të Rufanos, ajo në historinë e saj ka pasur një kryetar bashkie të Leçes, poeteshën e njohur Izabela (Isabella), e cila zë vend edhe në Enciklopedinë italiane të Njerëzve të Shquar. Kanë pasur edhe avokatin Federino, i cili në gjyqin politik kundër republikanëve garibaldinë të famshëm si Luixhi Setembrini, Filipo Agresti dhe Silvio Spaventa, u bëri një mbrojtje të zjarrtë. Nuk mungon në biografinë e familjes së tyre Kastrioti të degëzimit të Leçes edhe një komandant Garde Mbretërore, po ashtu edhe një bashkëshorte ministri të Brendshëm.

STËRNIPI I SKËNDERBEUT PËL-  
QEHET NGA TURQIT MODERNË



• Isabella Castriota Scanderbeg

Ndërsa në degën kastriotase të Napolit, gjatë gjysmëshekullit të jetës në Itali bien më shumë në sy veprimtarët politikë dhe shtatet e lartë, në atë të Leçës zotërojnë intelektualët dhe siluetat fizike më të brishta. Këtë prirje të tyre e përfaqëson shumë dallueshëm trashëgimtari i tanishëm, Alessandro Castriota Scanderbeg. Ai është, në profesionin e vet të mjekut radiolog, shkencëtar. Bashkë me një koleg të tij, Bruno Delapikola, ka shkruar librin "Abnormal Skeletal Phenotypes" ("Raste skeletore jonormale"). Bëhet fjalë për një vëllim me afro një mijë faqe, lëndë të cilën ia kishim parë me kohë, që kur qe dorëshkrim dhe e punonte në Romë. Libri u pëlqye dhe u botua menjëherë nga Springer Verlag në fillim të dhjetorit të vitit 2007. Pastaj u prezantua në SHBA në një takim të madh mjekësh nga e gjithë bota. Që prej këtij çasti, libri shitet në të gjithë globin dhe duke qenë krijesë diturie, ai blihet kryesisht nga mjekë të specializuar. Kjo është një nga arsyet që çmimi i këtij

botimi të thellë në përmbajtje, por vizualisht edhe mjaft luksoz dhe me ilustrime pamjesh, shitet nga një vend në tjetrin me çmimin prej 110 deri edhe tek...549 dollarë. Me kohë disa revista evropiane, përfshi edhe një çeke, i bënë recensione të posaçme.

Por surpriza ndodhi diku tjetër, atje ku edhe fantazia më kokëkrisur e kishte të vështirë të depëronte: në Turqi. Në motin 2008, ndodhi një ngjarje në të kundërt të merakut të mësipërm: Turqia u tregua e hapët. Këtë vit, në vitrinat e disa prej librari me kryesore u shfaq libri i doktor Aleksandrit "Abnormal Skeletal Phenotypes". Ndërkohë njëri nga websitet-t më të njohura të librave në këtë vend, "Izmir Tip Katabevi", i bënte reklamë të dukshme. Emri i autorit shkencëtar ishte vënë i plotë Castriota-Scanderbeg, Alessandro.

#### IZABELA, JETA E SAJ E PAZAKONSHME

Poeteshës Izabela Kastrioti (Scanderbeg) nuk i çel vend me për-

fillje të dukshme vetëm Enciklopedia italiane e Njerëzve të Shquar. Emri i saj, me një vëllim jo të vogël shpjegues, gjendet edhe në fjalorin enciklopedik të famshëm italian, Treccani. I përgatitur nga Nikolla Merola (Nicola Merola). Zëri i saj "CASTRIOTA SCANDERBEG, Isabella" shënon se ka lindur në Leçe, më 1 shtator 1704 prej prindërve Alessandro dhe Irene Pieve-Sauli. Fjalori Treccani thotë se "familja atërore rridhte prej Gjergj Kastriotit, të quajturit Skënderbe". Më pas informon se i ati i saj, Alessandro, sapo kishte hyrë, atë kohë, në rrethet fisnike të Leçës. "Në fakt, vijon Merola, pati ardhur në Kopertino bashkë me të atin e tij Vitanonio, për t'u martuar me Katerina Xhustiniani (Caterina Giustiniani), njëri prej familjeve lokale më të spikatura. Gruaja e vet e dytë qe prej një huadhënësi të pasur të Galipolit, e cila, përveçse e bëri baba për herë të parë, për meritë të dhuntive të saj financiare ripërtëriu gjendjen ekonomike të shkatërruar të familjes Kastrioti dhe rikonfirmoi e forcoi lidhjet me qarqet e shtresës së lartë të krahinës së Salentos".

Fjalori enciklopedik Treccani në vijim shpjegon se "Tetë ditë pas lindjes së dy binjakeve, prej të cilave jetoi vetëm Izabela, nga ethet gjatë lehonisë vdiq edhe e ëma, duke e lënë trashëgimtare të bijën. Kur pas kësaj që i ndodhi, në krye të dy viteve nga humbja e gruas së dytë, Alessandro Castriota u martua me të renë nga Roma, Xhuzepina de Torres (Giuseppina De Torres), u shfaq fare

i qartë fati i së bijës. E futën në një manastir". E gjithë kjo, rrëfen Treccani, ndodhi sepse gruas së tretë i duhej ta shmangte të voglën Izabelë nga e drejta e trashëgimisë prej të ëmës së saj të pasur, Irene Pieve-Sauli. Ca më shumë që kjo martesë e tretë e Alessandro Castriota qëlloi e plleshme: lindën dy meshkuj. Paolo Fraçesko (Paolo Francesco) dhe Vitanonio. Ky, siç e kemi shpjeguar më lart, u martua me Donica Castriota Scanderbeg të baronëve të qytezës Galiano. Duke i ngjarë kështu gjithë me po të njëjtin emër, i cili po ashtu pati vënë kurorë e kryer lidhje gjenetike, brenda gjakut kastriotas.

Fjalori enciklopedik Treccani shkruan se Izabela u fut, në janar 1715, në manastirin Santa Kiara (Santa Chiara), në Galipoli. Këtë kohë është vetëm njëmbëdhjetë vjeçe. Vendosi në këtë kuvend murgeshash e pati dëshiruar daja i saj, Xhanbatista (Giambattista), i vetmi pasardhës i mbetur gjallë nga familja Pieve-Sauli. Ky njeri mjaft i pasur dhe pa fëmijë, me këtë zgjedhje të vet, nuk deshi vetëm ta largonte mbesën prej manastireve të tjerë famëkëqij të Leçës, por edhe për t'i rregulluar një martesë dhe kështu, duke qenë se dega e tij qe shuar, t'i siguronte familjes së tyre vazhdimësi. Lidhja bashkëshortore u vendos, pa dijeninë e Izabelës, me baronin Filippo Guarini. Ky qe një 60-vjeçar nga qyteza e Tullies. Ceremonia u krye në 11 dhjetor 1720, në shtëpinë e Xhanbatista Pieve-Sauli, i cili atëherë qe kryetar i bashkisë së saj.

Zemërgjerësia e bashkëshortit të moshuar nuk qe e mjaftueshme për t'ia shlyer Izabelës dëshpërimin e pësuar, deziluzionin e cili gjeti shkrim vetëm në ankimet që, nëpërmjet letrave, i bënte vazhdimisht të atit. Përveç periudhave të shkurtra të kaluara në Leçe dhe në Galipoli, poetesha e ardhshme mbeti shtatë vite, nga gjashtëmbëdhjetë deri në njëzetë e tre, në krah të një burri mjaft ndryshe nga ajo jo vetëm prej moshës, por edhe prirjeve. Kjo gjendje u ndërpre vetëm me ndarjen më në fund të dy bashkëshortëve, çfarë nuk u krye nëpërmjet divorcit ligjor, por mirëkuptimit të ndërsjellë. Njëkohësisht kjo u bë edhe me një kusht dashamirës të baronit: Izabela të rikthehej në Konservatorin Santa Anna në Leçe. Në 1732, pa kompromentuar raportet me të shoqin, i cili vazhdoi t'i plotësonte nevojat e saj ekonomike, por ndërkohë duke blerë me çmim të shtrenjtë konsensusin e të atit dhe duke humbur favorët e dajës, Izabela e braktisi Konservatorin, ku pati kaluar vite të pasura me studime dhe zbulime intelektuale dhe hyri në shoqërinë e lartë të Leçës, duke shkaktuar me këtë rast kërshë-

ri dhe thashetheme. Këtë kohë, ndërta bënte pjesë në një Akademi, u njoh dhe ra në dashuri me një figurë letrare mjaft të njohur: Pietro Beli (Pietro Belli). Kur burri i saj Filippo Guarini ndërroi jetë, më në fund u hap shtegu për të kryer martesën e re. Kjo ndodhi në 22 qershor 1741. Izabela ndërkohë kishte marrë prej testamentit të baronit zemërmadh jo pak trashëgimi. Një vit më pas, lindi Raimondina dhe në 1745 vajza e dytë Irene Katerina (Irene Caterina). Kjo qe edhe periudha kur ra në sy për vargjet e saj.

Disa vite më pas, mbi të u bënë kërcënime për ta burgosur për borxhe që kishte i shoqi, Beli, i cili qe aq i pacipë sa nuk vidhte vetëm të tjerët, por edhe të shoqen. Ndërkohë Xhanbatista Pieve-Sauli në vitin 1748, vdiq. Një dëshpërim i madh e kapi Izabela Kastrioti Skënderbe kur pa se daja nuk e kishte përfshirë në pasurinë e ndarë në testament, sepse gjithçka ia pati dhënë një nipi. Kjo ia shpejtoi vdekjen, çfarë ngjau në Leçe më 4 mars 1749. Gjithsesi Izabela, në Itali kastriotasja më e famshme pas Skënderbeut, qe me fat. Më së pari rridhte prej një shqiptari që ishte bërë hero jo vetëm i vendit të tij, por i tërë Europës, E dyta, ishte mjaft e talentuar. E treta, pati një jetë të dhimbshme. Po ta kishte pasur të trëndafiltë shumë më pak poete do të qe dhe nuk do të tërhiqte kurrë vëmendje të shkrimit historik italian.

#### PROFESOR XHANKARLO VALONE

Dega e Leçës me traditën e saj intelektuale ka edhe një emër, Xhankarlo Valonen. Ky profesor i historisë së institucioneve politike në Universitetin e Salentos është bashkëshorti i Paola Castriota Scanderbeg, motrës së Alesandros dhe Xhulios. Ai është autor i një libri unik: "I Kastrioti in Terra d'Otranto" ("Kastriotët në Tokën e Otrantos"). Kur u publikua qe viti 1993, kurse Valone e Paola u lidhën me martesë më 30 shtator 1995. Madje profesori, ciklin e studimeve të tij për pasardhësit e Skënderbeut dhe të shumë familjeve fisnike shqiptare të kësaj periudhe, e pati nisur që në vitin 1981 ("Aspetti giuridici e sociali nell'età aragonese. I Kastrioti in Terra d'Otranto", në shqip "Pamje juridike dhe shoqërore në kohën e mbretërimit aragonëz. Kastriotët në Tokën e Otrantos"). Pra profesori Xhankarlo, "asi nën mëngë" që familja Kastrioti, dega e Leçës, ka, përbën një ndihmë të madhe dijeje, argumentimi dhe mbrojtjeje shkencore për të vërtetën e pasardhësve natyralë të Skënderbeut në Itali. Ai mund të quhet edhe më i mirë historian i tanishëm për këtë temë.

(gazeta shqip)

(vijon në numrin e ardhshëm)

## 28 NËNTORI I FESTUAR NË NJË AEROPORT

Kur në fund të nëntorit 2007, Aleksandri u nis për të marrë pjesë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës në takimin ndërkombëtar të neurologëve dhe ku do të zinte vend edhe promovimi i librit të tij (me bashkautor Bruno Delapikola) "Raste skeletore jo normale", ziente nga dëshira që 28 Nëntorin ta përjetonte ndërsa ndodhte ky prezantim. Por kjo nuk

ndodhi, Takimi u shty dhe u mbajt më 2 dhjetor. Kështu ai e festoi të shenjtën ditë të 28 Nëntorit, të lidhur me jetën e triumfin në histori të stërgjyshit të tij, por edhe të Shqipërisë si shtet i mëvetësuar, në transit, kur qe në Aeroportin e Milanos, në pritje të ndërrimit të avionit që nëpër natë do të kalonte Atlantikun.



• Alessandro Kastrioti Scanderbeg

# MEDIA KROATE ZBULON VRASËSIN E IVANOVIQIT

"Serbët nuk e kanë të panjohur ta heqin qafe cilindo politikan të tyre, i cili nuk u shkon për shtati. Ne kemi shërbim jashtëzakonisht të fortë të inteligjencës dhe të paralajmërimit. Kreu i ynë politik është i vetëdijshëm se duhet ta njohim Kosovën... Meqë Ivanoviçi me aktgjykimin për krime nuk u ka pëlqyer kosovarëve, ka qenë zgjidhje ideale për likuidim, me të cilin Serbia do ta drejtonte gishtin kah Kosova. Thjesht, kanë kërkuar mënyrë për t'i ndaluar bisedimet..."

Vrasja e Oliver Ivanovicit, liderit të Iniciativës Qytetare "Liri, demokraci, drejtësi" e ka tronditur me themel Serbinë e Kosovën, por i ka shqetësuar edhe të gjitha shtetet përreth, të cilat dëshmojnë për tensione të përditshme të ndërsjella të dy vendeve, shkruan portali kroat Dnevno.hr. Ivanovicin e likuiduar, prokuroria e Kosovës e ka akuzuar për krime lufte mbi popullatën civile në Kosovë, të bëra në vitin 1999 e 2000, duke e paraqitur si komandues të formacioneve paramilitare. Dhe deri sa faji i kosovarëve për shumëkënd imponohet si e vetmja përgjigje e arsyeshme në pyetjen se "kush është vrasësi", ndërsa lufta parashihet si rrjedhë logjike, një burim i informuar mirë portalit tonë i ka zbuluar anën tjetër të tregimit.

"Nuk do të ketë kurrfarë pasojash e as që do të ndodhë kurrfarë lufte ndërmjet Serbisë e Kosovës. Është krejtësisht e sigurt se e ka likuiduar shërbimi sekret dhe se Serbia e ka miratuar këtë. Ivanoviçi, në fakt, është shkolluar në Zagreb dhe ka qenë bashkëpunëtor i KOS-it (shërbimit sekret të Armatës Popullore Jugosllave), ndërsa nuk është fshehtësi se ka qenë njeri i besueshëm i Aleksandar Vasileviqit, shefit të shërbimit të KOS-it. Vështirë është të shitet tregimi

se shërbimet sekrete nuk kanë ditur se kjo do të ndodhë. Serbia zyrtare vrasjen e Ivanoviqit heshtazi e ka lejuar dhe, nëse nuk ngrihet shumë zhurmë e mediave, për këtë që pasnesër nuk do të flasë më askush". Teoria e burimit të portalit Dnevno.hr mbështetjen e mundshme e ka në faktin se vetëm dy ditë para atentatit, CIA sigurisht e informuar, ka dhënë paralajmërim alarmues për Kosovën, me të cilin ka tërhequr vërejtjen për terrorizëm të mundshëm dhe dhunë të motivuar politikisht, e cila pa-

raqitet anembanë vendit.

"Serbët nuk e kanë të panjohur ta heqin qafe cilindo politikan të tyre, i cili nuk u shkon për shtati. Ne kemi shërbim jashtëzakonisht të fortë të inteligjencës dhe të paralajmërimit. Kreu i ynë politik është i vetëdijshëm se duhet ta njohim Kosovën... Meqë Ivanoviçi me aktgjykimin për krime nuk u ka pëlqyer kosovarëve, ka qenë zgjidhje ideale për likuidim, me të cilin Serbia do ta drejtonte gishtin kah Kosova. Thjesht, kanë kërkuar mënyrë për t'i ndaluar bisedi-

met...". Mbi urgjencën e zgjidhjes së situatës kosovare-serbe, këto ditë kanë bërë të ditur edhe mediat serbe. "Amerikanët tashmë po i humbasin nervat, sepse dëshirojnë ta mbyllin tregimin mbi Kosovën si shtet i pavarur me pranimin në OKB, gjë që pushteti aktual i Beogradit është dashur ta përfundojë në vitin 2015. Tash do të bëjnë gjithçka që të marrin atë që kanë planifikuar, sepse për shkak të premtimeve të kreut shtetëror serb se do të përfundojnë me Kosovën e kanë mbështetur Aleksandar Vuçiqin dhe pushtetin e tij, duke i mbyllur sytë para shuarjes së opozitës dhe censurën e mediave". A është kjo vrasje zgjidhje të cilën e ka miratuar vetë Aleksandar Vuçiqi për t'iu shmangur njohjes së Kosovës, sigurisht se kurrë nuk do të merret vesh.

Mirëpo, se si i është drejtuar në mënyrë dramatike publikut ka zbuluar më shumë se sa është dashur. Vuçiqi, në fakt, ka shprehur dëshirën që Serbia t'i bëjë hetimet, ka premtuar zbulimin e vrasësit dhe i ka qeruar hesapet me të gjithë ata të cilët "kanë marrë guximin të mendojnë se ai personalisht ka ndonjë lidhje me këtë", shkruan portali kroat Dnevno.hr.

## THAÇI MIRËPRET NDIHMËN E BEOGRADIT NË ZBARDHJEN E VRASJES SË IVANOVIQIT

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, kërkesën e shtetit të Serbisë që t'i kryejë hetimet për vrasjen e politikanit serb nga Kosova, Oliver Ivanoviçi, e ka interpretuar si "ndihmë" që ky shtet mund të japë në zbardhjen e rastit. Thaçi ka njoftuar se gjatë një bisede telefonike me presidentin e Serbisë, Aleksander Vuçiq, janë dakorduar për shumë çështje. "Një çështje e veçantë, e cila u diskutua ndërmjet dy presidentëve, ishte edhe vrasja e djeshme e kryetarit të Iniciativës Qytetare "Liria, Demokracia, Drejtësia" (SDP) Oliver Ivanoviçi. Lidhur me këtë çështje presidenti Thaçi ka siguruar presidentin Vuçiq se organet përgjegjëse të prokurorisë dhe policisë janë duke bërë hetime intensive për zbulimin dhe sjelljen përpara drejtësisë të atyre që e kanë bërë këtë vrasje", ka thënë ai.



## Ka ndërruar jetë Jonuz Musliu

Jonuz Musliu, kryetar i Këshillit Kombëtar Shqiptar në Serbi, njëherit, kryetar i Asamblesë komunale të Bujanocit, ka ndërruar jetë paraditen e së enjtes në spitalin "Trakia Univerasitet" të Edrenës në Turqi. I ndjeri, Jonuz Musliu, kryetar i Lëvizjes së Progresit Demokratik, ndërroi jetë në moshën 59-vjeçare pas një sëmundje të gjatë të zemrës dhe veshkave, ku pas vetës ka lënë bashkëshorten dhe tre djemta, Fatlumin, Shqiprimin dhe Sarandin.



## Atentati e ka vënë seriozisht në pyetje dialogun

Atentati ndaj Oliver Ivanoviçi seriozisht e ka vënë në pyetje dialogun ndërmjet Beogradit e Prishtinës, ka vlerësuar ish-emisari i BE-së për Kosovën Wolfgang Petritsch. Petritsch në një bisedë për gazetën vjeneze "Die Presse", ka thënë se e ka goditur shumë vrasja. "E kam njohur Ivanoviqin, sigurisht në fazën më të vështirë të konfliktit të Kosovës, si një njeri të mençur, njëri nga të rrallët në anën e Milosheviqit i cili sinqerisht luftonte për zgjidhjen e problemit të shumicës shqiptare. Nuk dëshiroj të spekuloj për prapavijën, por atentati e ka vënë seriozisht në pyetje dialogun", ka sqaruar ai. Ai ka theksuar se tani është me rëndësi që çështjet e hapura të zgjidhen sa më shpejt në Bruksel. Duke theksuar se gjithmonë e ka përkrahur Gjykatën Speciale në Kosovë, Petritsch ka thënë se me rëndësi është që ajo të kufizohet në rastet eklatante.

## Policia amerikane arreston 11 shqiptarë për trafikim droge



Një operacion i gjerë që ka përfshirë tri shtete ka bërë të mundur arrestimin e të paktën 11 personave me shtetësi shqiptare të dyshuar për përfshirjen në rrjetin e trafikimit të lëndëve narkotike. Banda e shpërndarjes së heroinës u shkatërrua të mërkurën e 16 janarit. ABC raporton se shqiptarët e cilësuar si "mafiozë me reputacion" kishin shtrirë aktivitetin e tyre në Staten Island, Brooklyn dhe New Jersey.

Në këtë operacion morën pjesë agjentë të një task force të DEA-s, detektivë të NYPD (Departamenti i Policisë së New York City) dhe anëtarë të tjerë të agjencive federale dhe shtetërore. Ata mësohet se kryen disa arrestime dhe kontrolle në vendndodhje të ndryshme. Po ashtu mediat amerikane bëjnë me dije se një operacion i ngjashëm është duke vijuar ende.

“Nuk mund t’i bëjmë gabimet që i kemi bërë në vitin 2011, kur largimi i parakohshëm nga Iraku i mundësoi Al Kaidës atje të mbijetojë dhe të transformohet në Shtet Islamik”, tha Tillerson

Sekretari amerikan i Shtetit, Rex Tillerson, tha se trupat e Shteteve të Bashkuara do të mbeten në Siri për kohë të pacaktuar, jo vetëm për të luftuar militantët, por edhe për të kundërshtuar pushtetin e presidentit sirian, Bashar al-Assad, dhe të aleatit të tij, Iranit. Tillerson tha se misioni i ushtrisë amerikane do të përqendrohet në shkatërrimin e grupit militant Shtetit Islamik dhe parandalimin e kthimit të tij. Një synim tjetër, shtoi ai, është të krijohen kushtet për liderë të rinj që do të zëvendësojnë Assadin. Tillerson e përshkroi presidentin sirian si “vrasës”. “Tërheqja totale e personelit amerikan në këtë kohë do të bënte që Assadi të vazhdonte trajtimin brutal të popullit të tij”, tha Tillerson para një audience në Universitetin Stanford. “Mosangazhimi i Shteteve të Bashkuara në Siri po ashtu do t’i mundësonte Iranit të forcojë pozicionin e tij brenda Sirisë”, tha Til-

# TRUPAT AMERIKANE MBETEN NË SIRI



lerson. “Siç e kemi parë nga luftërat e Iranit dhe deklarimet e tij publike, ai kërkon dominimin në Lindjen e Mesme dhe shkatërrimin e aleatit tonë, Izraelit”, shtoi sekretari amerikan i Shtetit. Shtetet e Bashkuara kanë të vendosura rreth 2,000 trupa tokësore në Siri, ndërsa aeroplanët e tyre patrullojnë mbi lindje të vendit dhe ndjekin mbetjet e Shtetit Islamik, i cili

është mposhtur vitin e kaluar. Pas dëbimit të militantëve nga kryeqyteti i tyre i vetëshpallur Raka dhe zona të tjera në verilindje të Sirisë, SHBA ka punuar me Forcat Demokratike Siriane, një milici e dominuar me luftëtarë kurdë. Uashingtoni tani është duke e ndihmuar këtë milici në krijimin e një force prej 30,000 vetash, e cila do t’i siguronte kufijtë e Sirisë me

Irakun dhe Turqinë dhe do të parandalonte rikthimin e militantëve. Ky veprim është kundërshtuar fuqishëm nga Irani, Turqia dhe Siria. Duke shpallur vendimin për mbajtjen e trupave në Siri, Tillerson tha se Uashingtoni nuk po futet si luftëtar në konfliktin civil të Sirisë, i cili ka nisur shtatë vjetë më parë. Ai po ashtu tha se SHBA nuk kërkon ndryshim të dhunshëm të



REX TILLERSON

**Tërheqja totale e personelit amerikan në këtë kohë do të bënte që Assadi të vazhdonte trajtimin brutal të popullit të tij. Mosangazhimi i Shteteve të Bashkuara në Siri po ashtu do t’i mundësonte Iranit të forcojë pozicionin e tij brenda Sirisë**

regjimit. Sipas tij, roli i SHBA-së do të jetë sigurimi i qëndrueshmërisë, që do të mundësonte rifillimin e procesit paqësor dhe gjetjen e alternativave të regjimit të Assadit. Edhe pse theksoi se SHBA nuk është e interesuar në ndërtimin e misionit afatgjatë në Siri, Tillerson tha se Uashingtoni nuk duhet të përsërisë “gabimin” që ka bërë duke u larguar nga Iraku. SHBA është tërhequr nga Iraku në vitin 2011, tetë vjet pasi ka rrëzuar regjimin e Saddam Husseinit. Uashingtoni është kthyer në këtë vend në vitin 2014, me personel shumë më të vogël, për të luftuar Shtetin Islamik. “Nuk mund t’i bëjmë gabimet që i kemi bërë në vitin 2011, kur largimi i parakohshëm nga Iraku i mundësoi Al Kaidës atje të mbijetojë dhe të transformohet në Shtet Islamik”, tha Tillerson.

## Macroni i ashpër me emigrantët

Presidenti i Francës, Emmanuel Macron planifikon një ligj të ri imigrimi dhe azili. Fokusi kryesor është në radhë të parë dëbimi i azilkërkuesve të refuzuar. Kritikët e akuzojnë Macronin se ka tradhëtuar idealet e tij



Fitorja në zgjedhje e Emmanuel Macronit vitin e kaluar kundër Marine Le Penit të Front National u konsiderua si fitore e humanizmit kundër armiqësisë ndaj të huajve. Por në çështjet e migrimit, Macroni tani po sillet më ashpër se ç’e kishin pritur shumë vetë. Në vizitën e tij të martën në qytetin port të Francës veriore Calais, ku emigrantët përpiqen që të hipin në tragetet për në Britaninë e Madhe, Macroni tha se në të ardhmen, kush do të kapet duke bërë këtë, kundër tij shteti do të nisë “automatikisht” dëbimin. Pre-

sidenti lëshoi bubullima edhe kundër organizatave të emigrantëve, të cilat sipas tij mbrojnë një kauzë të përbashkët me emigrantët ilegalë dhe përhapin mes tyre “informacione të gabuara”. Kjo nuk ishte e para shprehje e Macronit, e cila të çon tek një linjë më e ashpër: “Asgjë nga ajo që bën qeveria nuk i vë pikëpyetje së drejtës së azilit”, tha Macroni javën e kaluar, “por azil nuk do të thotë që të pranosh pa dallim këdo”. Franca po përjeton aktualisht “valë migrimi të cilat nuk i ka përjetuar që prej Luftës së Dytë Botërore”, tha Presidenti dhe i përmendi vetë shifrat. Sipas auto-

riteteve franceze, në vitin 2017 u paraqitën 100.000 kërkesa për azil, 17 përqind më shumë se një vit më parë, por prej tyre statusi refugjati mori vetëm një e treta. Ministri i Brendshëm, Gerard Collomb shtoi më vonë: “Po të qëndronin të gjithë, ne duhet të ndërtonim çdo vit një qytet të ri të përmasave të mesme”. Në krahasim me Gjermaninë, ku në vitin 2017 erdhën 187.000 vetë, kjo megjithatë është shifër e vogël. Macroni ndodhet nën presionin e një atmosfere kundër të huajve të përhapur në vend. Politikisht atë e mban gjallë edhe më tej Front National, por

gjithnjë e më shumë për të kontribujnë edhe republikanët konservatorë, në kryetarin e tyre të ri Laurent Wauquiez. Wauquiez kërkon ta kufizojë migrimin në një “minimum të rreptë”. Për ta zgjidhur problemin, Macroni ka premtuar një ligj të ri imigrimi, i cili do të diskutohet muajin e ardhshëm në kabinet. Thelbi i tij: të gjithë azilkërkuesit duhet të trajtohen mirë - gjë që me sa duket nuk ka qenë e vetëkuptueshme deri tani - integrimi i atyre që e fitojnë azilin do të përmirësohet. Nga ana tjetër, të gjithë atyre që u refuzohet kërkesa për azil do të dëbohen në mënyrë shumë më konsekuente. Ligji i ri i imigrimit dhe i azilit, me aq sa ka depërtuar deri tani në publik, thekson para së gjithash dëbimin dhe frikësimin. Kështu “njësi mobile” do të kontrollojnë qëllimisht strehimoret e azilkërkuesve në kërkim të personave pa dokumente. Në vend të 120 ditëve, ata do të kenë në të ardhmen vetëm 90 ditë për t’ua paraqitur autoriteteve dokumentet e tyre. Për të konstatuar identitetin, personat do të mbahen në arrest në vend të 16 orëve tani, 24 orë në të ardhmen.

## Egjipt, burg të përjetshëm për Jusuf Kardavin

Gjykata ushtarake e Egjiptit ka shqiptuar dënim me burg të përjetshëm për 17 persona, shtatë prej të cilëve në mungesë, në mesin e të cilëve gjendet edhe kryetari i Unionit Botëror të Dijetarëve Muslimanë Jusuf el-Kardavi. Sipas të dhënave të siguruar nga burime gjyqësore, Gjykata Penale Ushtarake në veri të Kajros vendimin e ka shqiptuar në gjykimin ndaj 17 personave në lidhje me “atentatin ndaj kolonelit Vail Tahun në vitin 2015 në Kajro”, prej të cilëve Kardavi dhe gjashtë të tjerë janë gjykuar në mungesë. Në gjykim, Kardavi është ngarkuar me akuzat “nxitje në krim, vrasje, përhapje lajmesh të pavërteta dhe dëmtim të pronës publike”. Ndërkaq, gjykata ka vendosur për lirinë e 26 personave, në mesin e të cilëve gjenden katër anëtarë të Vëllazërisë Muslimane. Vendimi mund të ankimohej. Sipas ligjeve të Egjiptit, vendimet gjyqësore mund të ankimohen në afat prej 60 ditësh.



Qerim LITA

Shovinizetët maqedonas të fshatrave të rrethit të Gostivarit, në pjesën e dytë të të ashtuquajturit "Libri i peticionit" në pika të shkurta e paraqesin "arsyeshmërinë" përkatësisht "qëllimin" e hartimit të atij dokumenti, ku siç do të shohim në vazhdim, në stilin alla-milloshëviçjane, do të kërkojnë marrjen e masave të rrepta si nga ana e maqedonasve po ashtu edhe nga vet shteti, për siç thuhej ndërprerjen e politikës "agresive" të shqiptarëve, që në kohë të fundit "po manifestohet gjithnjë e më shpesh në republikë". Këto masa, sipas tyre duhej të ndaheshin në dy pjesë: urgjente dhe afatgjate, përkatësisht, sistematike. Si masa urgjente parashikoheshin moskonstituimi i kuvendeve komunale në pjesën perëndimore të Maqedonisë, për shkak dominimit të deputetëve shqiptarë, përkatësisht të dy partive të atëhershme shqiptare PPD-ë dhe PDP-ë, deri në shpalljen e zgjedhjeve të reja parlamentare dhe e dyta, shqiptarëve të mos u jepet "as çfarë funksioni" përkatësisht "resori" në pushtetin ekzekutiv republikan. Ndërkohë, të vazhdohej me masa tjera, sistematike, afatgjate, përmes së cilave shqiptarët me Kushtetutë të shpallëshin "pakicë nacionale", të pezullohej veprimtaria politike e Partisë për Prosperitet Demokratik dhe Partisë Demokratike Popullore, të mos lejoheshin përdorimi i flamurit shqiptar, të dëboheshin nga vatrat e tyre, të gjithë ata shqiptarë, të cilët na paskan "zbritur nga qielli" me qëllim të "uzurpimit" të "hapësirës nacionale e territoriale maqedonase", si dhe të gjithë ata, veprimtaria e të cilëve është "nacionalist-problematike". Përveç kësaj, ata kërkojnë që Qeveria e RSM-së, të parashihet arritjen e një marrëveshje me Qeverinë e Republikës së Shqipërisë, për shpërnguljen e shqiptarëve nga këto troje për në shtetin shqiptar "ngjashëm si ajo e viteve pesëdhjeta", që Tito e arriti me diplomatin e atëhershëm turk Fuat Kypryli, me ç'rast brenda gjashtë viteve qenë dëbuar me dhunë rreth 150.000 shqiptarë. Për këta albanofob e shovinizetë të tërbuar maqedonas, të gjitha ato masa, kishin karakter "mbrojtës" dhe të njëjtat ishin të "domosdoshme", të "pa shmanjura", "urgjente", dhe të "arsyeshme" historikisht, për arsye siç thuhej në pjesën e fundit të dokumentit "këta mysafir të pa ftuar nga bota islame", nuk kanë "dëshmuar dhe nuk do të dëshmojnë asnjëherë për një jetesë të përbashkët me krishterët". Se çfarë në të vërtetë thuhej në pjesën e dytë e të tretë të këtij dokumenti, të njëjtin në vazhdim po e paraqesim në tërësi:

#### QËLLIMI

Me dhënien e profilit përkatës, do të thoshim adekuat të situatës

## DOKUMENTE EKSKLUZIVE

# NJË DOKUMENT QË HEDH DRITË MBI SHOVINIZMIN MAQEDONAS NDAJ SHQIPTARËVE (2)

Për arsye se ka qëllime nacionalist-primitive dhe ndërhyrje të shpejtë me qëllime të hapura të pushtimit nacional e territorial, nataliteti i shqiptarëve të përkufizohet në veçori të jetesës fisnore, të zhvillohen bisedime me vendin e tyre amë, ashtu sikurse ishte rasti me marrëveshjen e Jugosllavisë në vitin 1950 (mendohet për shpërnguljen e dhunshme të shqiptarëve për në Shqipëri, një proces i cili gjatë viteve pesëdhjeta qe zbatuar me Republikën e Turqisë...

politike e të përgjithshme në RSM-ë, mund të thuhet - se po shijohen qëllimet e formulimit të ashtuquajturës "Libri i peticionit". Pikërisht, agresiviteti politik i pakicës shqiptare në RSM-ë, si përmes liderëve të tyre, gjithashtu edhe në përgjithësi, po manifestohet gjithnjë e më shpesh në republikë. Format e parqitjes së tyre, kryesisht janë standarde mirëpo futen edhe të reja sikurse janë:



- Përzjerjen e toponomisë me hidronominë, futjen e karakteristikave shqiptare, ndryshimin e bazës sllave.

- Marrjen e pushtetit komunal në komunat e republikës e ngjashëm, sikurse ashpërsimi i vazhdueshëm i shkallës, vullit dhe të metodës.

Kjo mënyrë e veprimit imponon angazhimin më të madh, më të shpejtë, më efikas e të përhershëm të kombit maqedonas e të shtetit, të ndërmer masa përkatëse kushtetuese e ligjore, përfshi edhe trajtimin juridik ndërkombëtar, të OKB-së për pakicat. Këshilli ynë iniciativ-aksionar, si qëllim i parashtrori aktivitetet:

#### A. URGJENTE

1. Kuvendet komunale nga Maqedonia Perëndimore, të mos konstituohen deri në zgjedhjet e reja



parlamentare, për arsye se dominonjë deputetët e PPD-së e të PDP-së.

2. Në parlamentin republikan, të mos u jepet thajse as çfarë, ose jo aq funksione të rëndësishme ose resore deputetëve të PPD-së e të PDP-së.

#### B. SISTEMATIKE MË AFATGJATE E KUSHTETUESE

1. Me Kushtetutën e re të RSM-së, pakicës shqiptare (pakicave në përgjithësi) në asnjë mënyrë të mos u jepet trajtimi i kombit (udhëzim me definim të rreptë).

2. Të pezullohen e shlyhen nga

regjistri i RSM-së dhe nga karta politike partitë jomaqedonase (një-nacionale) sikurse PPD-ë e PDP-ë të shqiptarëve të cilët dëshirojnë ta ndajnë e ta pushtojnë në tërësi hapësirën e territorit maqedonas.

3. Në RSM-ë përkatësisht në RSFJ-ë, të mos lejohet të valoj flamur jomaqedonas përkatësisht jugosllav.

4. Të kthehen prapa - të dëbohen nga Maqedonia dhe nga Jugosllavia të gjithë njerëzit nacionalist-problematik e aktiv nga pakica shqiptare të ardhur nga cilido vend edhe atë nga viti 1960 e këndej.

5. Për arsye se ka qëllime nacionalist-primitive dhe ndërhyrje të shpejtë me qëllime të hapura të pushtimit nacional e territorial, nataliteti i shqiptarëve të përkufizohet në veçori të jetesës fisnore, të zhvillohen bisedime me vendin e tyre amë, ashtu sikurse ishte rasti me marrëveshjen e Jugosllavisë në vitin 1950 (mendohet për shpërnguljen e dhunshme të shqiptarëve për në Shqipëri, një proces i cili gjatë viteve pesëdhjeta qe zbatuar me Republikën e Turqisë - Q. L.).

#### REZYME

Nevoja e madhe për ta shkruar përmbajtjen e mësipërme (hyrjen dhe qëllimin) ndërsa me domosdoshmërinë e ndërmarrjes së masave të nënvizuara, kombëtarisht do të jemi më afër e më efikas për ta penguar moton e paramenduar të pakicës shqiptare për sundimin ose ndarjen e hapësirës nacionale e territoriale maqedonase.

Masat mbrojtëse të propozuara, të cilat duhet t'i zbatohet kombi dominues maqedonas, janë të domosdoshme, të pashmanjura, urgjente, të arsyeshme historikisht e të tanishme. Këta mysafir të paftuar nga bota islame, nuk kanë dëshmuar e asnjëherë nuk do të dëshmojnë veti për jetesë të përbashkët me të krishterët, që do të thoshim se, posedojnë antagonizëm e ndjenjë të lindur për agresivitet e dominim. Veçoritë e këtyre faktin e pamohueshëm historik e të tanishëm për, as çfarë tolerance të mëtutjeshme në trajtimin kushtetues përkatës të RSFJ-së e RSM-së, që e rregullon të drejtën ndërkombëtare për pakicat pranë OKB-së.





# SI NDIKOJNË FEMRAT NË TRURIN E MASHKULLIT

Ekziston teoria e cila thotë kështu: derisa femrat për të sharmuar gjininë e kundërt mbështeten para së gjithash në pamje, meshkujt mbështeten në karakter, sharmë dhe inteligjencë - prandaj sjellja e tyre në situatat e tilla përjeton ndryshime më të mëdha

Shpesh themi që meshkujt "për një moment bëhen budallenj" kur e shohin një femër shumë të bukur. Duket që tani ka edhe mbështetje shkencore për këtë. Hulumtimet e reja tregojnë që madje edhe vetëm përmendja e emrit të femrës mund të ndikojë përkohësisht në punën e trurit të mashkullit. Universiteti holandez Radboud ka kryer testet në 90 heteroseksualë të rinj meshkuj dhe femra.

Detyra ka qenë që të lexojnë me zë fjalë të shkurtra nga goja e hulumtuesve, derisa i ka xhiruar kamera. Kur u është thënë meshkujve që janë duke i shikuar femrat përmes ekraneve, do të pasonin ndryshimet: meshkujt do ta

kryenin detyrën më dobët. Nga ana tjetër, kur femrave u është thënë që meshkujt janë duke i shikuar, nuk ka pasur asnjë ndryshim. Udhëheqësi i hulumtimit, psikologu Johan Karremans, ka konkluduar në deklaratën për Daily Mail: "Vetëm përmendja e femrave ishte e mjaftueshme për të reduktuar aftësitë kognitive të meshkujve". Ai ka shtuar që të anketuarve madje nuk ka pasur nevojë as t'u tregohet se çfarë femre po i shikon, apo se a ka pamje atraktive apo jo. Hulumtuesi i njëjtë që në vitin 2014 ka kryer hulumtimin i cili ka konkluduar që mashkulli i përballur me femrën vuan nga "budallallëku" i përkoh-

shëm. Shkencëtarët nuk kanë shpjegim për këtë dukuri, e as edhe për dallimin e dukshëm në mes reagimit të femrës dhe mashkullit kur përmendet gjinia e kundërt.

Ekziston teoria e cila thotë kështu: derisa femrat për të sharmuar gjininë e kundërt mbështeten para së gjithash në pamje, meshkujt mbështeten në karakter, sharmë dhe inteligjencë - prandaj sjellja e tyre në situatat e tilla përjeton ndryshime më të mëdha. Megjithatë, duhet theksuar që moshë mesatare e të anketuarve ishte 21 vjeç, çka jep shpresë që meshkujt me kalimin e kohës do të sillen më me maturi.

## Ngel shtatzënë ndërkohë që ishte shtatzënë

Një grua në Turqi ka ngelur shtatzënë për herë të dytë duke pritur në bark një fëmijë tjetër. Ajo është shprehur se pasi ka bërë kontrollin e parë ka qenë shtatzënë me një fëmijë, dhe në kontrollin e dytë janë shokuar kur kanë parë dy. Të dy bebet kanë ardhur në jetë në të njëjtën kohë, ku fëmija i parë ka lindur 2.5 kg dhe fëmija që është ngjizur më vonë 1.5 kilogramë. Fëmijët e gjinisë mashkull janë të dy në gjendje shumë të mirë shëndetësore. Një ngjarje e tillë në Turqi ndodh për herë të parë teksa është rasti i 12 në histori.

## Si të mbrojmë duart nga i ftohti



Kemi apo jo dorashka fakti është që i ftohti dëmton lëkurën tonë. Duke u kujdesur për fytyrën por edhe duart është një rritje e përditshme tashmë në këtë periudhë. Përkundrazi, duart, shumë të ekspozuara ndaj të ftohtit ekstrem meritojnë më shumë vëmendje. **LARJA E DUARVE.** Sigurisht që zakoni i larjes së duarve është mëse i përditshëm, por kur kemi të bëjmë me mot të ftohtë këshillohet të mos përdoret shumë sapun dhe të lahen me ujë të vakët. Kjo për të mbajtur lëkurën e duarve të pastër dhe të hidratuar.

**TË BUKURA DHE TË BUTA.** Një aleat i mirë për duart është vaji i ullirit. Lëkura e fytyrës dhe duarve është më e ekspozuara ndaj të ftohtit prandaj në fund të ditës duhet ti masazhoni për të mbajtur të buta dhe për të larguar qelizat e vdekura. Këtë mund ta bëni duke përzier disa lugë vaj ulliri dhe mjaltë, dhe pak qumësht apo kos.

**MOS E HUMBNI KURRË VËMENDJEN.** Mes kremërave, është mirë të zgjidhni ato të cilësishë së parë. Përveç tyre, ato që kanë në përbërje vaj kokosi apo gjalp shea, të pasura me veti të shumta parandalojnë plakjen e parakoshme, gjithashtu dhe vaji i bajames i pasur me vitaminë E.

**PARA SE TË FLINI.** Para se të flini duhet të masazhoni lehtësisht duart, duke bërë të mundur që vaji të penetrojë në brendësi të lëkurës dhe të riaktivizojë qarkullimin. Do të ishte më mirë të nisni nga majat e gishtave deri në fund të pëllëmbës.

## Gripi që shërohet vetëm me marrëdhënie seksuale!

Një lloj gripi i quajtur Aussies mund të shërohet vetëm duke pasur marrëdhënie seksuale. Kështu, thonë disa ekspertë të Universitetit 'Wilkes' në Pensilvani, të cilët e hulumtuan këtë lloj gripi. Se si mund të ndikojë seksi në shërimin e këtij virusi, hulumtuesit e shpjegojnë se seksi mund të rrisë prodhimin e Imunoglobulin A, një antitrop që lufton infeksionin dhe mund të ndihmojë në mbrojtjen e njerëzve nga infektimi i viruseve, shkruan Daily Mirror. Sipas këtij studimi, njerëzit që flinin me partnerin e tyre një herë ose dy herë në javë kishin 30% më shumë se imunoglobulinë A, se ata që nuk kishin marrëdhënie seksuale. Rezultatet kanë treguar se seksi mund të ndihmojë në uljen e niveleve të stresit, të cilat mund të pengojnë



ndjenjën e keqe, si dhe të jetë një formë ushtrimi që mund të ketë efekt të njëjtë. Mënyra të tjera zbatimëse për nxitjen e sistemit

imunitar të sugjeruar nga hulumtuesit përfshijnë masazhet e rregullta, bashkimin me një klub librash dhe marrjen e një gjumi të

mirë të natës. Njerëzit që vuajnë nga gripi Aussies ka arritur në 18 persona të cilët kanë kërkuar edhe trajtim spitalor.



Në përvjetorin e 550 të vdekjes së Gjergj Kastriotit - Skënderbeut, Muzeu i Kosovës dhe Museum Illyricum nga Zvicra organizuan sonte një ekspozitë me libra, pulla dhe bankënota nga Mesjeta e deri në vitet e 30-ta.

Ilir Xheladini, koleksionues dhe arkeolog, tha se në këtë ekspozitë ka sjellë disa artefakte nga Mesjeta e deri te vitet e 30-ta, të cilat kanë të bëjnë me kryetrimin shqiptar Gjergj Kastrioti-Skënderbeu. Xheladini tha se e gjithë puna e tij është bërë me pasion të plotë dhe se artefaktet e prezantuara në

## ARTEFAKTE NË PËRVJETORIN E VDEKJES SË SKËNDEBEUT

këtë ekspozitë do të kthehen në Zvicër, raporton kp.

Drejtori i Muzeut të Kosovës, Skënder Boshtrakaj, tha se kjo është ekspozitë e përbashkët me koleksionistin Xheladini, i cili ka shumë materiale dhe investon shumë për të mbledhur fakte dhe dokumente për historinë e shqiptarëve dhe ilirëve.

"Unë kam parë me shumë

rëndësi që ta prezantojmë një koleksion tonin dhe një ide për Muzeun Ilirikum dhe kjo të ndodhë në shenjë përkujtimi për heroionë kombëtar në 550-vjetorin e vdekjes, me disa pulla dhe informata shtesë si një kalendar të rëndësishme që nga lindja e heroit dhe tutje ku ka dhënë kontribut edhe Jahja Dranqolli me një hartë ku janë të prezantuara mo-

numentet që prezantojnë heronjtë tanë kombëtar dhe me disa grafika ku është një zonjë e rëndë që gjuan lule në përkujtim të Skënderbeut dhe një grafikë tjetër që është bukuria e asaj, natyra e shqiptarit, ku para heroit shihen disa shqiptarë të feve të ndryshme, të cilët e nderojnë dhe e përcjellin në atë botë me lutjet e veta", ka thënë Boshtrakaj.

## Pas 100 vitesh, zbulohet vizatimi i panjohur i Van Gogh-ut



Vizatimi i panjohur i piktorit holandez Vincent Van Gogh është shfaqur në Holandë. Skica me pikturë njëngjyrëshe e quajtur "The Hill of Montmartre", i përket vitit 1886, dhe u realizua pak pasi ai u shpërngul në Paris. Vizatimi, së bashku me një pikturë tjetër të ngjashme, "Hill of Montmartre", u zbulua të martën në muzeun Singer Laren, pas verifikimit të hollësishëm. Z. Meedendorp beson se gjetja e rrallë është më e lidhur me stilin e mëparshëm

formal të Van Gogh, të cilin ai e zhvilloi në Akademinë e Artit në Antwerp, para se të shkonte në Paris, ku puna e tij u bë më eksperimentale. Ndërkohë, u zbuluan edhe dy portrete të pazbuluara nga mjeshtri, holandez Govert Flinck për herë të parë në Muzeun e Amsterdemit, pasi u humbën në 1895. Pikturat e shekullit të 17-të nga Flinck, një student i Rembrandt, u varën në muret e dhomës së banimit të pronarit të tyre.

## Gjenevë, ekspozon artistja nga Ferizaji

Artistja nga Ferizaj, Lebibe Topalli-Shabani ka hapur dje (e njte) në galerinë e njohur të Gjenevës "Cité du Temps" ekspozitën e saj personale të titulluar "The time" - "Le temps" (Koha). Ekspozita do të qëndrojë e hapur deri më 28 shkurt 2018.

Ekspozita përbëhet nga tri tërësi: "The time", "Don't Stop My Time" & "Non-Stop". Emërtimi "The time" i ekspozitës lidhet me një arsye të fortë, pasi që është koha ajo që kalon të gjitha dhe mbijeton përgjithmonë, shkruan albinfo.ch. Është koha ajo e cila ndjek besnikërinë e njeriut duke shkaktuar përherë paradokse. Dhe është zemra jonë sinonimi i tiktakut që mat kohën. Është e evidente se secila pikturë e kësaj ekspozite tregon akrepat e orës, të cilët krijojnë qarkun e tyre përcaktues. Në shumicën e këtyre krijimeve artistike shpërfaqet optimizmi përmes ngjyrave të ngrohta dhe të buta, përveç te kapitulli "Don't stop my time", pikturat e të cilit si laitmotiv kanë ndërjegjë-

simin e njerëzve, shkruan albinfo.ch. Ndërgjegjësimit lidhur me atë që kohën duhet ta vlerësojmë dhe ta përdorim në mënyrë pozitive sepse ajo nuk ndalon kurrë dhe ne mund ta humbasim atë.

Lebibe Topalli-Shabani është e lindur në Ferizaj në vitin 1981. Ajo ka mbaruar studimet për arte pamore në Universitetin e Tetovës ndërsa masterin në arte e ka bërë në Universitetin e Prishtinës. Aktualisht punon si mësime në Shkollën e Mesme të Arteve "Çesk Zadeja" në Ferizaj. Maksima që artistja përdor më së shpeshti është "Jeta ime është e mbushur me ngjyra, ngjyrat kanë krijuar rrugën time". Shumica e punimeve që do të ekspozohen në Gjenevë



janë të punuara në teknikën akrilike në kanavacë, ndërsa disa tyre janë kolazh. Qendra Kulturore e Koosvës në Cyrih do të ndihmojë



## Edhe një artist shqiptar në Stamboll

Në Stamboll prej datës 19 Janar deri më 11 Shkurt do të mbahet Edicioni i parë i Festivalit Ndërkombëtar të Fotografisë, ZFotoFest. Në këtë edicion do të prezantohen 54 projekte në formë ekspozite duke përfshirë edhe punime të emrave të njohur botëror si fotografët e National Geographic Ami Vitale e Mathew Paley si dhe emra të tjerë si Abelardo Morell, Corey Arnold e Kamil Firat... Samir Karahoda do të prezantohet me projektin Centenarian i cili paraqet portretet e grave 100-vjeçare të Kosovës, projekt i cili edhe u ekspozua në Prishtinë në Galerinë e Ministrisë së Kulturës. Po ashtu, në festival do të ketë një numër të madh aktivitetesh si uorkshope, debate, biseda, prezantime të portfolive të fotografëve të rinj ku po ashtu edhe autori Samir Karahoda të dielën me 21 Janar do të mbaj një Artist talk për të folur për punën dhe eksperiencën e tij si fotograf. Hapja zyrtare e festivalit dhe ekspozitës do të bëhet të Premten me 19 janar prej orës 19.30 në qendrën kulturore në rajonin e Zeytinburnu të Stambollit. Të ju kujtojmë, projekti "Centenarian", paraqet Historinë e nënave Kosovare të cilat kanë arritur të jetojnë mbi një shekull ku përmes portreteve të tyre paraqitet karakteri i tyre i fortë dhe historia përmes rrudhave në fytyrë.

në pjesën organizative të ekspozitës si ofrimi i koktejit të verërave nga Kosova dhe i muzikës instrumentale në hapje.

RENDITJA E FIFA-S

# SHQIPËRIA NGJIT DY, MAQEDONIA TRE VENDE

FIFA ka publikuar renditjen e kombëtareve për muajin e fundit dhe Shqipëria e Panuçit vazhdon të ngjitet lart në arenën ndërkombëtare dhe tani ndodhet e 60-ta, duke u ngjitur dy pozicione. Derisa, për tre vende është ngjitur përfaqësuesja e Maqedonisë



Nuk ka luajtur asnjë ndeshje për këtë periudhë, por kombëtarja jonë kuqezi është ngjitur dy vende në klasifikimin përkatës të FIFA-s. Nëse për dhjetorin e vitit të kaluar ishte në vendin e 62-të, tashmë Shqipëria e sheh veten e 60-ta, me 553 pikë. Po kaq pikë kishin edhe muajin e kaluar kuqezinjtë, por spostimi i përfaqësuesve të tjera ka sjellë këtë lëvizje në klasifikimin e radhës. Kujtojmë se kulmin e kulmeve në këtë renditje, Shqipëria e pati në muajin gusht 2015, vendin e 22-të në FIFA. Një rekord historik në ranglistën e kombëtareve të gjithë botës. Sa për histori, vendi i 84-t ka qenë pozicioni më i keq, që ka pasur kombëtarja shqiptare nën drejtimin e Xhani De Biazit. Këtë pozi-

cionim kuqezinjtë e kanë pasur në muajt prill, maj, tetor dhe nëntor 2012. Ndryshe, përfaqësuesja e Maqedonisë është ngjitur tre vende dhe tani verdhekuqtë mbajnë pozitën e 73 dhe në kontinuitet vazhdojnë të ngjiten në tabelën e përfaqësuesve më të mira botërore. Njëherit për Maqedoninë ky është plasmani më i mirë në shtatë vitet e fundit dhe ky është një

sinjal i mirë për seleksionuesin e saj Igor Angelovski dhe futbollistët para shortit për Ligën e Kombeve, e cila do të mbahet më 24 janar në Lozanë. Maqedonia është bartëse ndërmjet përfaqësuesve në Ligën D, nga gara e sapoformuar prej UEFA-së. Ndërkohë, Kosova ka rënë për një pozitë në renditjen më të re të FIFA-s, ndonëse nuk ka zhvilluar asnjë ndeshje që

nga muaji nëntor. Tani Kosova zë pozitën e 178-të, me 97 pikë. Sa u përket renditjes së 10 skuadrave më të mira, nuk ka asnjë ndryshim. Kryeson Gjermania, e ndjekur me radhë nga Brazili, Portugalia, Argjentina, Belgjika, Spanja, Polonia, Zvicra, Franca dhe Kili. Edhe në këtë rast "status quo"-ja në top-10-she shpjegohet me mungesën e ndeshjeve.

## Nuk mjaftojnë dy golat e Cikalleshit

Sulmuesi i Kombëtares shqiptare, Sokol Cikalleshi ka qenë njëri i ndeshjes ndaj Beshiktashit në Kupën e Turqisë, duke shënuar të dy golat për skuadrën e tij të Osmanlispor në triumfin 2-1. Deri në minutën e 83 ndeshja ishte e mbërthyer në barazim pa gola, ndërsa të parët që shënuan ishin miqtë dhe krijuan idenë e fitore. Por, skuadra e Osmanlispor nuk u dorëzua dhe mbi të gjitha shqiptari Cikalleshi, i cili realizoi dy herë në fundin e takimit duke përmbysur shifrat. Por, për fat të keq, dy golat e Cikalleshit nuk kanë mjaftuar për Osmanlispor që të vijonte më tej në Kupën e Turqisë. Ndeshja e parë kishte përfunduar 4-1 për Beshiktashin, skuadër e cila ka vijuar më tej në Kupën e Turqisë me rezultatin e përgjithshëm 5-3. Megjithatë, Cikalleshi tregon një formë të mirë me skuadrën e Osmanlispor.

MAQEDONIA E PARA NË GRUPIN C

## Synohet gjysmëfinalja

Shkup, 18 janar - Përfaqësuesja e Maqedonisë ka arritur që të kryesoj Grupin C në Kampionatin Evropian të hendbollit që po mbahet në Kroaci. Në ndeshjen e tretë ndaj Gjermanisë, djemtë e seleksionuesit Raul, nxorën rezultat pozitiv, duke barazuar 25-25, duke arritur kështu ta ruaj kryesimin në grup

dhe të kualifikohet për raundin e dytë. Ndeshjet e radhës Maqedonia do të zhvillojë në Varazhdin më 21 janar, (ora 20.30) ku do të përballlet me Spanjën, pastaj Danimarkën (23 janar ora 20.30) dhe Çekinë (24 janar ora 18.15). Synimi i verdhekuqve do të jetë plasmani në gjysmëfinale.



## Shkupi dhe Drita ndahen në paqe

Shkup, 18 janar - Skuadra e FC Shkupit dhe KF Drita nga Gjilani kanë barazuar 1-1 në miqësoren e zhvilluar dje në Gjorçe Petrov. Sipas informatave nga kampi bardheblu, është zhvilluar një ndeshje tipike kampionale. Të parët në epërsi kaluan futbollistët e Shkupit me anë të Alen Jasharovskit në pjesën e parë. Skuadra nga Gjilani ka mundur të barazojë rezultatin në 1-1, por nuk arritën të shndërrojnë në gol gjuajtjen nga pika e bardhë. Më pas në pjesën e dytë, djemtë e trajnerit Ardian Nuhiu u kërcënuan me anë të Bazhe Ilijoski në dy herë, Suhel Muharemit dhe Rron Brojës, por asnjëra nga këto raste nuk përfundoi në rrjetën e mysafirëve. Në anën tjetër, pas një kundërsulmi, gjilanasit nëpërmjet Astrit Fazliut barazuan rezultatin në 1-1, njëherit ky ishte edhe rezultati përfundimtar i kësaj ndeshje miqësore. Në këtë ndeshje për Shkupin luajtën edhe përforcimet e reja, Bazhe Ilijoski, Rron Broja dhe Bllagojçe Lamçevski, derisa pas një



paule të gjatë për shkak të lëndimit, në fushën e gjelbër është rikthyer Bunjamin Shabani. Ndërkohë, pas kësaj ndeshje, futbollistët e Shkupit do ta kenë të

lirë, ndërsa me stërvitje do të vazhdojnë të shtunën, ndërsa të hënën do të udhëtojnë në Antalia të Turqisë, për të vazhduar fazën e dytë të përgatitjeve. (B.K.)

“Unë mund të garantoj se në kontratën e Neymar nuk ka asnjë klauzolë lirim, as për objektivat, as për përfundimin e sezonit si golashënuesi më i mirë”, thotë Motta

Markos Motta, një nga avokatët e Neymar, u intervistua të mërkurën në “Radio Globo” dhe zbuloi se në kontratën e brazilianit me PSZH-në nuk ka asnjë klauzolë largimi nga klubi francez. “Unë mund të garantoj se në kontratën e Neymar nuk ka asnjë klauzolë lirim, as për objektivat, as për përfundimin e sezonit si golashënuesi më i mirë”, thotë Motta. Neymar nuk po arrin të gjejë në Paris lumturinë që kërkonte me nënshkrimin e tij për klubin e “Parc des Princes”. Pa shkuar më tej, këtë të mërkurë, ai u vërsëllye nga tifozët e tij në ndeshjen ndaj Dijon, teksa nuk lejoi Kavanin të ekzekutonte penalltinë dhe të bëhej golashënuesi më i mirë në historinë e PSZH-së. Neymar, i cili e përfundoi këtë ndeshje me katër gola të shënuar, shkoi në dhomat e zhveshjes

AVOKATI I NEJMARIT GËZON REALIN

# S’KEMI ASNJË KLAUZOLË LARGIMI NGA PSZH-ja



dukshëm i zemëruar. Ndërkohë, Florentino Pérez, presidenti i Real Madridit, ka fërkuar duart nga kjo situatë. Braziliani është një dëshirë e vjetër për drejtuesit e “Los Blancos”, të cilët nuk i kanë kursyer lavdet për të, duke u “ushqyer” edhe nga zemërimi i Cristiano Ronaldos. Motta, ekspert në të drejtën

ndërkombëtare sportive, ishte avokati që shqyrtoi të gjitha kushtet e kontratës mes Neymar dhe PSZH (ai ishte, gjithashtu, njeriu që mbikëqyrte, me kërkesë të Neymar Sr, dokumentacionin e rinovimit të brazilianit me Barçën). Vetë avokati zbuloi në “Radio Globo” se

ndodhi në korrik, kur mori thirrjen e babait të lojtarit për të lexuar kushtet e kontratës me klubin francez. “Babai i Neymar më dërgoi një SMS në mes të korrikut, për të më thënë të shkoja menjëherë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës për të shikuar kontratat”. Më 3 gusht, Neymar u transferua zyrtarisht te PSG për 222 milionë euro.



## Uest Hem me ofertë për Zhoao Marion

Uest Hem ka nisur bisedimet me Interin për të huazuar Zhoao Marion. Trajneri David Mojes ka nevojë për një organizator që të ndihmojë ekipin të largohet nga zona e rënies nga kategoria. Mario nuk ka lënë një përshtypje të mirë gjatë këtij sezoni me fanellën zikaltër dhe tanimë ka rënë i treti në listën e preferencave të trajnerit Spaleti, pas Borja Valero dhe Marcelo Brozović. Edhe ai vetë dëshiron të largohet nga “San Siro”, sepse nëse do të qëndrojë në stol rrezikon të humbasë vendin te Portugalia në Kupën e Botës 2018. Uest Hemi i ofron Zhoao Marios mundësinë për të luajtur rregullisht, pavarësisht se ai do të preferonte një klub më të madh për të vazhduar karrierën.

## Më 31 mars "dueli i shekullit" mes Xhushas dhe Parker



Boksi do të ketë sivjet një kampion që i mban titujt e të gjitha versioneve të boksit për kategorinë super të rëndë. Favoritët janë anglezi Antoni Xhoshua dhe amerikanii Deontaj Uilder, për që të dy duhet të fitojnë përballet në muajin mars, dhe të dy shpreh të gatshëm që pastaj të përballet me njëri tjetrin. Xhoshua përballet me Josep Parker, në duelin që bashkon titujt e tri versioneve (WBA, IBF dhe WBO) më 31 mars. Ai ka paralajmëruar se pas këtij dueli dëshiron të luftojë në duelin që do të bashkonte të gjithë titujt. Uilder do të mbrojë titullin në versionin WBC kundër kubanezit Luis Ortiz, më 3 mars. Edhe ky të hënën ka thënë se pas përballes së ardhshme dëshiron të luftojë në duelin ‘unifikues’. “Fituesi do të përballet me fituesin e duelit Xhoshua-Parker. Kjo

është rruga për luftën e madhe, luftën e unifikimit (të titujve). Një njeri do të ketë të gjithë rripat. Është sikur turne. Le të fitojë më i miri”, ka thënë Uilder. “Dy më të mirët do të përballet në një natë speciale, një moment special, të cilin do e shoh e gjithë bota. Për mua sa më parë të ndodh është aq më mirë, dhe besoj që tifozët pajtohen me këtë. Kurdo që ata janë gati, edhe unë jam gati”, u shpreh ai. “Unë nuk kam dyshim se do të fitoj luftën e ardhshme. Do e nokautoj Luis Ortizin, do të bëj atë që di më së miri, unë jam artist i nokauteve. Jam i specializuar për këtë. Do e shfaq këtë”, ka thënë Uilder. Legjenda e boksit, Xheroxh Foreman, e ka vlerësuar përballet e mundshme Xhoshua-Uilder si duelin më të madh të boksit modern.



## Vietnami, destinacioni i ri i Formula 1

Këtë vit, dy gara të reja i shtohen kalendarit të Formula 1: Franca me pistën “Paul Ricard” dhe Gjermania me Hokenheim. Bëhet fjalë për njohje të vjetra, por së shpejti duket se do të ketë edhe pista të reja. Sipas “Forbes”, Liberty do e çojë Formulën 1 deri në Vietnam, një vend me shumë pak traditë në automobilizëm dhe ku opsionet në merkato për skuadrat

dhe për vetë Botërorin nuk duken të mira. Por, këto janë zërat që kanë dalë nga mbledhja e kësaj jave në Londër e Shoqërisë së Promotorëve të F1, ku janë të përfaqësuar 21 garat e Botërorit. “Do të njoftohet së shpejti një garë urbane në Vietnam”, tha një burim për “Forbes”. Qëllimi është që të plotësohet boshllëku i lënë nga Çmimi i Madh i Malajzisë.

Publicitet

Në bazë të nenit 80 dhe 82 paragrafi 1 nga Ligji për arsim fillor (Gazeta zyrtare e RM 103/08,33/10,116/10,156/10,18/11,42/11 51/11 6/12 100/12, 104/12, 24/13, 41/14,116/14,135/14,10/15, 98/15,145/15,30/16 dhe 127/16) dhe nenit 22 dhe 23 nga Ligji për marrëdhënie pune (Gazeta zyrtare e RM nr.167/15), dhe Miratimi nga Ministria për Arsim dhe Shkencë nr. 12-12613/2 prej 06.12.2018, SHF “Goce Dellçev“-Konçe shpall:

### KONKURS

për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2017/2018

1. Një mësimdhënës i gjuhës angleze me 14 orë mësimore, si zëvendësues për mësimdhënësen në pushim të lindjes me rrogë bazë prej 14.460,00 denarë deri në kthimin e mësimdhënës nga pushimi i lindjes; Vendi i punës është për kohë të caktuar të punës deri në kthimin e mësimdhënës nga pushimi i lindjes. Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e parapara në Ligjin për marrëdhënie pune dhe Ligjin për arsim fillor të nenit 77 dhe nenit 80. Orari i punës është prej të hënës deri të premten prej ora 08:00 deri 13:30. Krahas fletëparaqitjeve për vendet e punës kandidatët duhet të parashtrijnë dëshmi për arsimin e mbaruar përkatës dhe certifikatë të shtetësisë. Dokumentet e parashtruar të jenë në original ose kopje të vërtetuara në noter. Dokumentet e nevojshme të parashtrohen në arkivin e shkollës. Shpallja zgjatë 5 ditë pune nga dita e publikimit. Zgjedhja e kandidatëve do të realizohet në afat prej 30 ditëve pas përfundimit të shpalljes publike. Lutjet e arritura pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

SHF “Goce Dellçev“-Konçe  
U. D Drejtor  
Cveta Angellova

MAROTTA FLET PËR EMREN, DYBALAN DHE MARKISION

# JEMI NË BISEDIME ME XHAN, DYBALA NUK ËSHTË NË SHITJE



"Emre Xhan është një lojtar që po i skadon kontrata kështu që kjo na lejon që të afrohem për negociatat, të cilat ne tashmë i kemi ndërmarrë. Unë nuk mund të them nëse ai mund të nënshkruajë kontratë të re te Liverpooli, por gjithë ajo që mund të them është se ne do të bëjmë gjithçka që mundemi për ta marrë lojtarin", pohon Marotta

Drejtori sportiv i Juventusit, Xhuzeppe Marotta, ka konfirmuar se "Bianconerët" po tentojnë ta transferojnë Emre Xhanin nga Liverpooli. Gjermani aktualisht ka kontratë me klubin nga "Anfield Road" e cila skadon në fund të këtij sezoni. Marotta thotë se ai dhe klubi i tij po tentojnë ta respektojnë Liverpoolin në këtë tratativë, por edhe vet rregullat.

"Emre Xhan është një lojtar që po i skadon kontrata kështu që kjo na lejon që të afrohem për negociatat, të cilat ne tashmë i kemi ndërmarrë. Unë nuk mund të them nëse ai mund të nënshkruajë kontratë të re te Liverpooli, por gjithë ajo që mund të them është se ne do të bëjmë gjithçka që mundemi për ta marrë lojtarin. Ai aktualisht është te Liverpooli dhe ne e respek-

tojmë Liverpoolin, por edhe rregullat", tha drejtori i Juventusit. Kujtojmë, Xhan ka kohë që është në radarin e Juventusit dhe gjiganti italian do të tentojë ta transferojë për një çmim të arsyeshëm në janar, më së largu gjatë verës në parametra zero, me variantin e dytë që nuk i përshtatet Liverpoolit. Në anën tjetër, Marotta ka folur edhe për Paulo Dybalan dhe Klaudio

Markision. Në një intervistë për mediat italiane hodhi poshtë çdo hipotezë që e jep të ardhmen e sulmuesit argjentinas larg bardhezinjëve. "Juventusit shet vetëm ata futbollistë që kërkojnë largimin por Dybala nuk është njëri prej tyre ndërsa edhe Klaudio Markhisio është një lojtar shumë i rëndësishëm për bardhezinjtë", përfundoi Xhuzeppe Marotta.

## Xheko sërish në Premier Ligë

Futbollisti boshnjak Edin Xheko mund të rikthehet në Premier Ligë pas dy sezonesh në Serinë A me Romën. Mediat britanike bëjnë me dije se skuadra kampione e Çellsit po mendon të rikthejë në Angli sulmuesin 31-vjeçar. Trajneri Antonio Conte beson se boshnjaku është njeriu i duhur për sulmin e "bluve" të Londrës, ndaj janë gati të marrin shtatë lart 1.93 metra i gjatë. Xheko vlerësohet 25 milionë euro dhe mund të vijë në Londër që në merkaton e dimrit, duke parë se Çellsit është në kërkim të një sulmuesi, pasi Miçy Batshuaji nuk po bind në atë rol dhe pritet të largohet. Problem mbetet Roma, që nuk kërkon të heqë dorë kollaj nga sulmuesi kryesor. Kujtojmë, Xheko ka luajtur në Angli në sezonet 2011-2016 me skuadrën e Mançester Sitit.



## Pike te Barcelona deri në vitin 2022

Pike do të vazhdojë të luajë me Barcelonën deri më 30 qershor 2022. Lojtari i Barcelonës ka vazhduar kontratën e tij për katër sezone të tjera dhe do të ketë një klauzolë përfundimi të saj prej 500 milionë eurosh. Pike ka luajtur për momentin 421 ndeshje me Barcelonën, duke shënuar 37 gola. Përveç kësaj, ai ka fituar gjithçka, që mund të fitojë në nivel të klubit, me Barcelonën: 3 Liga të Kampionëve, 6 La Liga, 5 Kupa Mbretit, 5 Superkupa Spanjolle, 3 Superkupa Evropiane dhe 3 Botëror për Klubet. Pike arriti te Barcelonë në



vitin 1997, me vetëm 10 vite mbi supë. Në vitin 2004, ai u largua nga shtëpia për të shkuar te Mançester Junajted, ku fitoi për-

vojë duke luajtur në Premier Ligë. Në verën e vitit 2008, në sajë të Pep Guardiols, Pike u kthye te Barcelona si mbrojtës qendror.

## Alli, ylli i radhës i super skuadrës së Raiolas

Ndërsa klubet takohen, diskutojnë, zihen, bien dakord dhe bëjnë operacione në këto javë të merkatos së futbollit edhe menaxherët realizojnë goditjet e tyre. Një nga më të fuqishmi në botë, Mino Raiola, duket se është afër marrjes së një tjetër super lojtari. Bëhet fjalë për yllin e Premier Ligës dhe Totenemit, Dele Alli. Lojtari kërkohet nga të gjithë klubet e mëdha të Evropës dhe duket se është shumë afër të bëhet pjesë e "skuadrës" së Mino

Raiolas, ku bëjnë pjesë kampionë, si Pogba, Lukaku, Donnarumma, Verratti dhe Matuidi. Lajmi është bërë i ditur nga "Independent", që ka shkruar se marrëveshja është pothuajse e arritur. Ajo që është e sigurt është fundi i marrëdhënies së punës mes Dele Alli dhe menaxherit të tij anglez Rob Segal, i cili, gjithmonë sipas tabloideve, nuk ka më besimin e lojtarit.



## LAJME SHKURT

### BELOTI KËRKON LARGIMIN NGA TORINO

Andrea Belotti nuk është më i kënaqur te Torino. Edhe pse pak ditë më parë ishte vetë lojtari ai që hodhi poshtë zërat se marrëdhënia e tij me presidentin Kairo nuk është e mirë, mediat italiane shkruajnë se e vërteta është krejt ndryshe. 24-vjeçari është në dyshim për qëndrimin e tij te skuadra "Granata", teksa dhe Milani ka shfaqur interes për afrimin e lojtarit. Klubi kuqezi po harton një plan për ta marrë në merkaton e verës sulmuesin italian.

### RODRIGEZ ZËVENDËSUES I KUTINJOS?

Liverpuli është një nga skuadrat që ka shfaqur interes për të firmosur me sulmuesin e Bajern Muni, Hames Rodrigez. Lajmin e bëjnë të ditur mediat spanjolle të cilat theksojnë faktin se kolumbiani i kanë mbetur edhe 2 vite huazim te bavarezët që e morën nga Reali i Madridit. Trajneri gjerman e dëshiron 26-vjeçarin te "The Reds" duke e parë dhe si një zëvendësues shumë të mirë të Kutinjos, që firmosi me Barcelonën.

### MEDIAT E ÇOJNË PASTOREN TE INTERI

Havier Pastore nuk është grumbulluar sërish nga trajneri i PSZH-së, Unaj Emery, për sfidën me Dijonin, duke e bërë thuajse të sigurt largimin e tij nga kryeqyteti francez. Argjentinasit, bashkë me Kavanin u rikthyen me vonë nga pushimet e vitit të ri dhe u lanë jashtë në ndeshjen e Kupës së Francës, por duket se për sulmuesin uruguian ka përfunduar dënimi, ndërsa për fantazistin argjentinas ende jo. Mediat franceze raportojnë se Pastore është me valixhet gati, ndërsa thonë se destinacioni më i mundshëm është Seria A, ku e pret Interi i Spaletit. Zikaltrit janë të vetmit që kanë shfaqur interes konkret për të dhe mbrëmjen e të hënës pati edhe një darkë mes menaxherit të Pastores dhe drejtorit sportiv të Interit, Piero Ausilio.

### REALI REFUZON TË NËNSHKRUAJË ME IBRAN

Presidenti i Real Madridit, Florentino Perez, ka refuzuar të nënshkruajë me Zlatan Ibrahimoviçin në këtë muaj. Agjenti i sulmuesit, Mino Raiola, ua ka ofruar suedzin klubit të Real Madridit, sipas "El Mundo Deportivo". Por mësohet se Perez e ka refuzuar ofertën, pasi ai nuk dëshiron të punojë me agjentin Raiola. Po ashtu edhe stafi i trajnerëve nuk e ka dashur që ta ofrojë në klubin, pasi nuk mendojnë se do të ishte e mirë për atmosferën në dhomat e zhveshjes.

Abubakarr sot punon, studion dhe luan futboll, sporti falë të cilit është integruar pothuajse menjëherë. Një histori kjo që ka mallëngjyer edhe një legjendë të futbollit, si Françesko Totti. Udhëtimi i Abu është kthyer në një simbol të guximit dhe revanshit, për ata që nuk heqin dorë nga ëndrrat dhe duan t'i arrijnë ato me çdo kusht

**N**jë histori që është edhe një shenjë shprese për të gjithë: në moshën 14 vjeç është larguar nga Afrika për një udhëtim të gjatë të shpresës nëpërmjet detit ku ka humbur një mik. Pasi ka mbërritur në Itali ka arritur të integrohet falë futbollit. Kjo është historia mallëngjyese e Abubakarr Konta, që është larguar nga Gambia për një udhëtim të gjatë që e ka çuar në Sicili, aty ku ka njohur dashurinë e njerëzve. Sot, ai punon, studion dhe luan futboll, sporti falë të cilit është integruar pothuajse menjëherë. Një histori kjo që ka mallëngjyer edhe një legjendë të futbollit, si Françesko Toti. Udhëtimi i Abu është kthyer në një simbol të guximit dhe revanshit, për ata që nuk heqin dorë nga ëndrrat dhe duan t'i arrijnë ato me çdo kusht. Një histori si shumë të tjera, një histori urie, vuajtjeje dhe emigrimi. Por edhe shprese dhe këmbënguljeje, sepse djaloshi i ri afrikan ka arritur atë që donte: lirinë dhe një jetë më të mirë. Edh falë futbollit, që është kthyer në një pikë referimi në ditët e tij siciliane, një element dallues, integrimi. Pas një pelegrinazhi të gjatë, të filluar më 2 shkurt të 2016-ës, bashkë me shokët.

"Jam larguar nga Gambia dhe kam shkuar në Senegal. Ditën që jam nisur shumë miq më kanë thënë të mos shkoja. Kam qarë. E ndieja se duhej të ikja. Kam kaluar dy javë në Senegal dhe më pas kam qëndruar për tri javë në Mali. Kam kaluar nga Burkina Faso dhe Niger për të arritur në Libi, kur kam qëndruar për tre muaj", filloi rrëfimin e tij për "UEFA.com" Konta. Më pas ai ka



# HISTORIA E JASHTËZAKONSHME E ABUBAKARR KONTA

mbërritur në Sicili, siç ka kujtuar në "Uefa.com" nuk kishte asgjë, as këpucë, vetëm një fanellë dhe pantallona. Por atje ka njohur dashurinë e njerëzve, mikpritjen e vërtetë, të pastër të atyre që duna të ndihmojnë të tjerët.

"Nuk kisha as këpucë. Më kanë ndihmuar të gjithë, kanë qenë të jashtëzakonshëm. Edhe tani janë shumë të dashur me mua", vazhdon më tej Abubakarr. Ai luan futboll dhe ka idhull Çabi Alonson, mesfushorin spanjoll që para pak kohësh është tërhequr nga futbollit pasi ka luajtur me klube, si Real Madrid, Bajern Munihi dhe Liverpool, duke koleksionuar 114 ndeshje me kombëtaren. Një pikë referimi personale për Abu. "Më pëlqente stili i tij i lojës. Kur isha në Gambia njerëzit më quanin Alonso".


Para historisë së Abu edhe Federata Italiane e Futbollit ka bërë pjesën e saj për të shkuar në ndihmë të të rinjve, si Abubakarr. Në fakt, ajo mbështet një projekt që merret

me zhvillimin e të rinjve në vështirësi nëpërmjet një fushate të ndërtuar rreth futbollit dhe vlerave që mund të përcjellë në shoqëri. Sot, Abu është 16 vjeç dhe pas pak ditësh do të festojë vitin e tij të dytë të zbakimit në Itali. Një lloj ditëlindje: fillimi i një jete të re, të ushqyer nga ëndrra për t'u

bërë një futbollist profesionist. Një histori që ka mallëngjyer edhe Françesko Totin, i cili ka postuar këtë mesazh në "Twitter". "Futbolli i bashkon njerëzit. Kjo është ajo që më pëlqen nga kjo lojë". Jam dakord plotësisht me fjalët e Abubakarr dhe i uroj më të mirat për të ardhmen", ka shkruar Totti.

Publicitet

## Pogba mund të përfundonte te Noçerino



Pol Pogba ka qenë shumë afër kalimit te Noçerino. Jo, nuk është fantazi, por ajo që ka pohuar ish-drejtori sportivi i klubit, Marsello Pitino: "Kemi marrë portierin Nikola Leali dhe bashkë me të mund të kishim marrë nga Juventus edhe Pol Pogba", ka thënë Pitino. "Në atë moment mund ta bënim këtë, sepse Konte nuk e konsideronte titullar dhe te ne mund të rritej. Kështu, kam shkuar ta ndjek në miqësoren e përvitshme që zhvillohet në Villar Perosa. Por, më pas nuk është bërë asgjë, sepse lojtarë kaq të fortë i tregojnë vlerat e tyre herët ose vonë. Ndoshta mund të mos kishte ndodhur te Noçerino, por më ka mbetur peng që nuk kam arritur ta marr. Nuk dihet si mund të kishin shkuar gjërat nëse Pol do të ishte marrë nga Noçerina", deklaroi Pitino.



PESTOVA SHPK

### THIRRJE PËR TENDER

NDËRTIMI I DEPOS "PËR DEPONIMIN DHE RUAJTJEN E PATATES NË KOHË TË GJATË"

- Referenca e publikimit : 01/2018
- Procedura : E Hapur
- Programi : MASA 103-INVESTIMET NË ASETET FIZIKE NË PËRPUNIMIN DHE TREGTIMIN E PRODUKTEVE BUJQËSORE (SEKTORI I PËRPUNIMIT TË QUMSHTIT, MISHIT, PEMËVE PERIMEVE DHE VERËS)
- Financuar : MBPZHR
- Autoriteti Kontraktues : PESTOVA Sh.p.k
- Lloji i Kontratës : Ndërtim
- Vendi : Pestovë, Vushtrri 42000, Republika e Kosovës
- Koha : Dorëzimi i ofertave duhet te behet deri me 02.02.2018, ora 16:00.
- Kriteri për përfutuesin e kontratës: Operatori më i favorshëm ekonomikisht
- Dosja për tender mund të kërkohet me shkrim ose me e-mail nga ana e operatorëve të autoritetit kontraktues: [vipa@pestova.org](mailto:vipa@pestova.org) ose [bedrikasumi@hotmail.com](mailto:bedrikasumi@hotmail.com)

Informata:

Për më shumë informata ju lusim kontaktoni direkt në zyrën e kompanisë Pestova në . +377 44 360 182

Afati i fundit për dorëzim të propozimit 02/02/2018, ora 16:00



Government of Kosovo  
Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development



**DASHI** 21. mars - 20. prill

Hëna në bashkëpunim me shenjën tuaj vazhdon t'ju nxjerrë nga telashet. Ata që nuk janë të kënaqur me gjendjen e tyre sentimentale do të enden në kërkim të njohjeve të reja. Beqarët do të jenë në një humor të mirë dhe do të pranojnë ftesat për takime. Yjet ju këshillojnë që të jeni sa më ambicioz në frontin e punës, dhe kjo do ju sjellë fitime të mira.



**DEMI** 21. prill - 21. maj

Re të zeza mbliiden sot në qiellin tuaj, dita ju paralajmëron për të gjitha llojet e ngjarjeve të papritura. Niveli i nervozizmit do të jetë i lartë dhe do të ndikojë emocionalisht tek ju. Hëna dhe Venusi në Ujor ngatërrojnë situatat e shumë personave të cilët në vend të kësaj kërkojnë qetësi. Në frontin profesional, ju mund të përdorni diplomacinë dhe gjithçka do ju ecë sipas planeve..



**BINJAKET** 22. maj - 21. qershor

Yjet në shenjën tuaj sjellin shumë lajme pozitive në dashuri dhe ju do të jeni të rrethuar nga një lloj magjie që do të rrisë mirëkuptimin me partnerin/en tuaj. Lajme të mira parashikohen edhe për ata që janë vetëm dhe që shpresojnë për një takim interesant me personin e duhur. Përfitoni nga ky moment pozitiv për të zgjeruar edhe biznesin ose karrierën tuaj.



**GAFORRJA** 22. qershor - 22. korrik

Një ditë plot surpriza dhe plot emocione të forta kjo e enjte për ju. Sot do të ndodhin vetëm gjëra të bukura dhe ju mund të merrni atë që dëshironi, madje edhe dashurinë e pakushtëzuar të partnerit/es. Trokitje zemre edhe për beqarët, shumë prej jush Gaforre do të takojnë shpirtin binjak. Detyrat e rëndësishme në punë vazhdojnë, ju jeni një hap larg nga marrja e asaj që dëshiron



**LUANI** 23. korrik - 22. gusht

Sot do të jeni nën presion për disa keqkuptime të shkaktuara nga një çështje familjare. Venusi ju shikon keq dhe vëzhgimet tuaja do të provokojnë grindje me partnerin/en tuaj. Takime aspak interesante janë rezervuar edhe për beqarët, ju jeni dembel dhe kjo i largon njerëzit. Marsi në Diell sjell në sipërfaqe disa probleme pune që dukeshin të zgjidhura. Jini të durueshëm.



**VIRGJERESHA** 23. gusht - 23. shtator

Në dashuri, shmanguni nga debatet e kota dhe në vend të kësaj tregoni veten të vëmendshëm dhe të dashur me partnerin/en tuaj. Disa gjëra duhet gjithmonë të kultivohen në mënyrë që të mos humbasin! Fati mund të rezervojë takime intriguese ndaj shumë prej beqarëve, por duhet të dinë të dallojnë më të mirat! Hëna dhe Venusi në fushën tuaj profesionale ju lejojnë të keni kënaqësi në iniciativat profesionale



**PESHORJA** 24. shtator - 23. tetor

Kush është duke jetuar një marrëdhënie të tensionuar me grindje dhe debate mund të përfundojnë edhe duke i dhënë fund asaj, por aty ku ka ende dashuri dhe sinqeritet do të mbijetojë. Beqarët do të ndjehen tërheqës dhe të dëshiruar sot, por do të kenë edhe momente dekurajimi. Sot yjet ofrojnë mundësi të mrekullueshme për punë dhe biznes.



**AKREPI** 24. tetor - 22. nëntor

Do të përpiqesh të mbash impulsin e lartë për të hedhur diçka që ke në zemrën tënde. Në mënyrë që të mos e keqësoni gjendjen e dashurisë, duhet të hiqni dorë nga debatet. Beqarët duhet të jenë të kujdesshëm në takimet e tyre. Nëse po kërkoni një punë të re veproni menjëherë. Hekuri rrihet sa është i nxehtë.



**SHIGJETARI** 23. nëntor - 21. dhjetor

Intuitat e tua do të jenë të rëndësishme për të bërë zgjedhjet e duhura sentimentale. Kujdes mos të jeni kontradiktor nëse nuk doni të humbni besueshmërinë. Dashuria bëhet e guximshme për beqarët, do keni një periudhë shumë fatlume. Sot në punë ju mund të merrni më shumë kritika se sa lëvdata. Kush-tojini vëmendje asaj që bëni dhe disiplinës.



**BRICJAPI** 22. dhjetor - 20. janar

Në dashuri, është momenti i duhur për të konsoliduar marrëdhënien tuaj, edhe nëse keni jetuar një marrëdhënie të gjatë në distancë për disa muaj. Nuk do të ketë më paqartësi! Beqarët do të përhapen në takime gjatë kësaj të enjte dhe kjo do t'i çojë ata të fluturojnë nga një lule në lule! Sot, mos e humbisni entuziazmin tuaj në diskutime të padobishme.



**UJORI** 21. janar - 19. shkurt

Shfrytëzoni mundësinë për të dalë nga rutina e përditshme! Me Venusin në shenjën tuaj do të ketë atmosferë harmonike dhe të magjepsur në jetën e një çifti. Takime interesante i presin edhe beqarët dhe shumë risi sentimentale në mbrëmje. Nëse jeni duke kërkuar një punë të pavarur, duhet të mos dorëzoheni para pengesës së parë.



**PESHQIT** 20. shkurt - 20. mars

Mërkuri kalon në aspektin e favorshëm tuajin dhe sfera sentimentale është në momentet e saj më të mira. Rutina në çift zhduket dhe ju ndihen shumë të qetë. Yjet njoftojnë një periudhë pozitive edhe për beqarët. Në punë po merrni rezultatet e asaj që keni mbjellë. Ju presin projekte interesante që kërkojnë një shpenzim të madh të energjisë.


**PËRKUJTIM**



**KASUM SADIKU**

Vitet kalojnë, por dashuria dhe kujtimet për ty nuk shuhen kurrë. Je gjithmonë me ne, në mendjet dhe zemrat tona. Kujtimi për ty do të jetë i përjetshëm dhe i paharruar. Me mall dhe pikëllim të kujton vëllai Mustafa nga Amerika dhe mbesat Fitorja dhe Valbona

**PËRKUJTIM**



**I dashur Osman,**  
Me 21 janar bëhen 5 vite që kur ndërrove jetë e ne nuk u mësuam ende pa Ty. Nuk pajtohemi dot me mungesën tënde vëlla. Shpresojmë dhe besojmë që po pushon i qetë shpirti yt ashtu si ishe i qetë dhe i urtë sa jetoje. Të kujtojmë përjetësisht. Vëllai Abazi me bashkëshorten Lilin dhe djemtë Visarin e Valonin



NE KETE DATE

|   |   |   |                 |   |
|---|---|---|-----------------|---|
| VEPRIMTARI E AUTORIT NE FOTO            | H | AUTORI NË FOTO (I BIRI I PETRO NINI L.) | SËMUNDJE DHEMBI | UJHESA E ODISEJUT                           |
| RRIP PËR PANTALLONA OSE FUNDE KASAFORTË |   |   |                 |   |
| A                                       |   |   |                 |   |
| (E) GJITHA                              |   |   |                 |   |
| I VETËM, I NJËSUAR                      |   |   |                 |   |
| QYTET NË KAMERUN                        |   |   |                 |   |
| ZË (TURQ.)                              |   |   |                 | SHENJAT QË JEPEN ME SHITREMBËRIM TË FYTYRES |
| FRANGA KLUB SPANJOLL                    |   |   | GRAMI ERBIUMI   |   |

19 JANAR 1900  
27 PRILL 1982

|                           |                        |   |   |  |   |  |                          |  |
|---------------------------|------------------------|---|---|--|---|--|--------------------------|--|
| Mensur Mamuti             | SAIMIR PIRGU           | NDARJE E MADHE ADMINISTRATIVE NË PERANDORINË OSMANE FRYN ME POMPË | V | MAJUMUNI TE RAMAJANA                             | MATEMATIKAN ZVICERAN, LEONARD NËSI E VJETËR PESHE |  |                          |  |
| LLOJ DINOSAURI            |                        |   |   |  |   |  |                          |  |
| SHUMË MIRË (GREQ.)        |                        |   |   |  |   |  | METRI JODI               |  |
| KOHA                      | ROMANI NAZMI RRAHMANIT | AKTORJA JONË, ALIKAJ  |   |  |   |  |                          |  |
| PËRKULJA, LAKIMI          |                        |   |   |  | NDËRTIMI MBI UJË SHKËLQIMI I KADIFESË             |  | SQUFURI ILIRIANA SULKUQI |  |
| VE (TETOVARÇE)            |                        |   |   | MBAJTJA E PADREJTË E ANËS SE DIKUJUT INTENSITETI |   |  |                          |  |
| LUFTËTAR KUNDER FASHIZMIT |                        |   |   |  |   |  |                          |  |

ZGJIDHJET: H, ASKI, ARKAT, TËRA, UNIK, EDEA, SES, FR, G, V, OJLER, SPINOSAURI, POLI KALA, M, MALESORJA, EPJA, URA, S, VOF, ANËSIA, ANTIFASHIST



## Britania me ministër për të vetmuarit

Londra ka emëruar ministrin për Vetmi me qëllim që të vazhdohet puna e deputetes së vvarë Joe Cox dhe që të zgjidhet problemi i izolimit me të cilin po ballafaqohet pothuaj çdo i 10 person në këtë vend. Këtë funksionin të ri, krahas funksionit aktual si ministre e sportit, do ta ushtrrojë, Tracey Crouch. Ajo do ta hartojë strategjinë për zgjedhjen e këtij problemi, për të cilin hulumtuesit thonë se ka lidhje me çmendurinë, vdekjen e hershme dhe me shtypjen e gjakut. Cox u vra në vitin 2016 nga ekstremistët pas ushtrimit të pozitës së deputetes më shumë se një vit. Shumica e më të vjetërve mbi 75 vjet jetojnë të vetmuar e rreth 200 mijë persona të moshuar në Britani nuk kanë folur me miq ose me të afërm më shumë se një muaj, thonë dokumente të Qeverisë britanike. Çdo ditë, shumica e mjekëve merr nga një deri në pesë thirrje në ditë prej pacientëve që kërkojnë ndihmë pasi janë të vetmuar, ka kumtuar "Fushata për përfundimin e vetmisë", rrjet që merret me zgjidhjen e këtij problemi. Cox kishte themeluar komisionin për shqyrtimin e kësaj çështjeje pak para se të vritej dhe kishte ftuar Qeverinë të emëronte ministrin që do të merrej me këtë çështje.

## Tenton të bllokojë teshtimën, thyen hundën

Të mbyllësh gojën dhe hundët në momentin që teshtinë, nuk këshillohet nga mjekët. Një 34-vjeçar britanik është shembulli i duhur se përse nuk duhet bërë kjo. Mjekët e një spitali në Leicester u habitën me rastin e 34-vjeçarit, emri i të cilit nuk bëhet publik. Ai u paraqit në urgjencë me hundën e thyer. Menjëherë pyetja e parë që doktorët i bënë ishte nëse ishte goditur me grusht, por përgjigjja që morën i habiti. 34-vjeçari rrëfeu se hundën e kishte thyer duke dashur të ndalojë një teshtimë.



## Droni i parë me pasagjerë, gati në mars

Një kompani britanike për ndërtimin e dronëve pretendon se ka gjetur më në fund edhe përgjigjen për t'i vendosur këto makineri në shërbim të udhëtarëve. Themeluesi i saj, Martin Warner, pretendon se droni i tij i ri ultra-i lëmuar do të jetë i aftë të transportojë udhëtarë nga "zemra" e Londrës në aeroportin e Heathrow për 12 minuta. Një udhëtim që normalisht, pa trafik të ngarkuar, realizohet për 25 minuta. Duket se britanikët nuk do të duhet të presin shumë, pasi 45-vjeçari Warner bën me dije se droni i parë në botë për transportin e udhëtarëve do të jetë gati në muajin Mars. Sipas tij, ky dron do të udhëtojë me 110 km në orë e do të ngrihet deri në 450 metra, duke përshkruar distanca pa ndalesa deri në 130 km.

## Brokoli mund të përdoret për trajtimin e kancerit

Shkencëtarët njoftuan që brokoli mund të përdoret në trajtimin e kancerit kolorektal (të zorrës së trashë). Sipas lajmit të publikuar nga agjencia Yonhap, një grup shkencëtarësh nga Universiteti Kombëtar i Singaporit, realizuan punime inxhinierike mbi probiotikët kundër kancerit të cilat gjenden në brokoli. Në studimin në krye të së cilit qëndronte Chang Matthew Wook, u zbulua se probiotikët e trajtuar, ndaluan zhvillimin e kancerit dhe stimuluan tërheqjen e qelizave të kancerit kolorektal. Gjatë punimit, në brendinë e probiotikut u vendos një molekulë e vogël organike e enzimës mirosina. U observua se në kushte laboratorike, kombinimi i këtyre probiotikëve me substanca parandaluese të kancerit si glykozinolatet, te minjtë dhe te njerëzit ndalon për 95 për qind shtimin e qelizave kancerogjene në zorrën e trashë. Detajet e studimit u publikuan në revistën "Nature Biomedical Engineering".



1419 - Qyteti francez Ruen dorëzohet para Henrit V pas luftës 100 vjeçare.

1493 - Franca i dorëzon Rusilonë dhe Kartagjenën Spanjës sipas Traktatit të Barcelonës

1668 - Mbreti Luigji XIV dhe Perandori Leopoldi I nënshkruajnë traktat për ndarje të Spanjës

1793 - Mbreti francez Luigji XVI dënohet me vdekje.

1795 - Revolucioni demokratik në Amsterdam përfundon oligarkinë

1806 - Britania okupon Kepin e Shpresës së Mirë.

1910 - Gjermania dhe Bolivia ndërpresin traktatin tregtar.

1913 - Raymond Poincaré vendoset si kryetar i Francës.

1942 - Forcat japoneze pushtojnë Burmën

1981 - SHBA dhe Irani nënshkruajnë marrëveshje për lirimin e 52 pengjeve amerikane


1986 - Spanja njeh Izraelin.

Kocka e njeriut (sidomos femuri) është rreth 4 herë më i fortë se betoni. Një pjesë e eshtrave e cila është sa një inç kub mund të mbartë një peshë 8.6 ton përsipër.



Një mesatare e meshkujve prodhon rreth 10 milion qeliza të reja të spermës çdo ditë. Ky numër i spermatozoideve të reja është i mjaftueshëm për të rripulluar të gjithë planetin në vetëm 6 muaj.

Sipas një mesatareje, sasia e nxehtësisë që një njeri çliron nga trupit në vetëm gjysmë ore është e mjaftueshme për të vluar një gjysmë-galon uji.



### MAKINA DHE BIONDJA

Telefonon një bionde në polici:  
- Më kanë hyrë në makine, më kanë vjedhur të gjitha, timonin, pedalet dhe levën e ndërrimit të marsheve, gjitha... Pas pesë minutash merr përsëri policinë dhe i thotë:  
- Ju kërkoj ndjesë, sepse kisha hipur në ulëset mbrapa.



I dobëti nuk mundet të falë kurrë.  
Falja është cilësi e të fortit.  
(Dr. Abdul Kalam)



KALENDARI HISTORIK 19 JANAR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS